



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



RAPORT

VJETOR PËR VITIN 2009

Shkurt 2010, Prishtinë

Përmbajtja

1. PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMEVE KRYESORE NË KOMUNË.....	4
2. MBLEDHJET E KUVENDIT, EKZEKUTIVIT DHE TRUPAVE PUNUESE	7
3. KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS.....	7
a. Aktivitetet e kabinetit të Kryetarit të Komunës	7
i. <i>Qeverisja komunale dhe bashkëpunimi ndërinstytucional.....</i>	8
ii. <i>Transparenca, komunikimi dhe përfshirja e qytetarëve në qeverisje.....</i>	8
iii. <i>Siguria publike</i>	9
iv. <i>Zhvillimi Ekonomik</i>	9
v. <i>Bashkëpunimit ndërkombëtar.....</i>	10
vi. <i>Kabineti i këshilltarëve të Kryetarit.....</i>	10
vii. <i>Kërkesat zyrtare të drejtuar në zyrën e Kryetarit:.....</i>	10
b. Aktivitetet e zyrave	10
i. <i>Zyra e prokurimit</i>	10
ii. <i>Zyra për marrëdhënie me publikun.....</i>	11
iii. <i>Zyra e përfaqësimit juridik.....</i>	12
iv. <i>Zyra ligjore</i>	12
v. <i>Zyra për integritet evropiane.....</i>	13
vi. <i>Zyra për auditim të brendshëm</i>	13
vii. <i>Njësia për të drejtat e njeriut.....</i>	14
viii. <i>Zyra për kthim.....</i>	14
ix. <i>Zyra për komunitete</i>	14
4. DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT	15
a. Sektori i punëve të përgjithshme dhe juridike.....	15
b. Sektori i bashkësive lokale.....	15
c. Sektori teknik.....	16
d. Sektori i gjendjes civile.....	16
e. Zyra pritëse	16
f. Zyra për teknologji informatike	17
5. DREJTORIA E EKONOMISË, FINANCAVE DHE ZHVILLIMIT	18
a. Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore	18
b. Sektori për buxhet dhe financa.....	19
c. Sektori i tatimit në pronë.....	20
d. Sektori i ekonomisë	20
e. Sektori i inspeksionit	21
f. Sektori për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	22
6. DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT	24
a. Sektori i Urbanizmit.....	24
b. Sektori i Kadastrit dhe Gjeodezisë.....	27
c. Sektori i Inspeksionit të Ndërtimit	28
d. Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit.....	28
7. DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCËS CIVILE	29
a. Shërbimi i Transportit	29
b. Shërbimi i Energjetikës.....	29
c. Shërbimi për mirëmbajtjen e Gjellbërimit	30
d. Shërbimi për mirëmbajtjen e rrugëve dhe varrezave	31
e. Sektori i Emergjencës Civile	31
f. Sektori i inspeksionit komunal.....	32

8.	DREJTORIA E ARSIMIT DHE KULTURËS	33
a.	Të dhëna për arsimin në Komunën e Prishtinës	33
b.	Ngritja e infrastrukturës shkollore, kulturo-sportive dhe furnizimet.....	34
c.	Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor dhe aktivitetet tjera.....	35
d.	Spektori i kulturës.....	36
e.	Spektori i sportit dhe rinisë.....	37
f.	Shërbimi i administratës	38
9.	DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS LOKALE	38
a.	Hartimi i detyrave projektuese dhe identifikimi i nevojave	38
b.	Shqyrtimi i kërkesave	39
c.	Projektet infrastrukturore	39
d.	Rrugët e përcjella në vitin 2010 për shkak të pengesave të ndryshme	44
e.	Hartimi i projekteve dhe përgatitja e dokumentacionit teknik	44
10.	DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE.....	45
a.	Spektori i Inspektionit sanitar	46
b.	Spektorit të mirëqenies sociale	46
11.	DREJTORIA E PRONËS	46
	ANEKSE	48
	Aneksi 1. Të dhënat për aktivitete e Kryetarit të Komunës gjatë vitit 2009.....	48

Raporti vjetorë për vitin 2009 i paraqitet Kuvendit të Komunës së Prishtinës në pajtim me dispozitat e nenit 40, pika 40.2 shkronja d të Ligjit nr 03/L-040 mbi vetëqeverisjen lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) dhe dispozitave të nenit 33 pika 33.1 shkronja d e Statutit të Komunës së Prishtinës 01 nr 110-455 dt. 31.3.2008.

1. PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMEVE KRYESORE NË KOMUNË

Qeverisja e Komunës së Prishtinës gjatë vitit 2009 ka përmirësuar më tutje menaxhimin e brendshëm dhe ka rritur dukshëm investimet kapitale duke siguruar edhe një alokim optimal të këtyre investimeve në sektorë dhe lagje të ndryshme të qytetit dhe fshatrave. Po ashtu, është rritur efikasiteti i menaxhimit urban të qytetit si në procedimin e kërkesave për leje ndërtimi, në trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe në menaxhimin e përgjithshëm të shërbimeve publike për qytetarë. Të gjitha këto ndryshime kanë ndikuar pozitivisht në cilësinë e jetës së qytetarëve. Komuna e Prishtinës është bërë anëtare e njërës nga institucionet me të rëndësishme evropiane të bashkëpunimit të qyteteve të mëdha EUROCITIES. Në vijim është paraqitur një përmbledhje e shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore, investimeve kapitale gjatë vitit 2009 sipas fushave, masat lidhur me menaxhimin urban etj. Informata më detale për këto janë paraqitur në pjesët përkatëse të këtij raporti.

Kapaciteti buxhetor i Komunës së Prishtinës

Gjatë vitit 2009, Komuna e Prishtinës ka përmirësuar më tutje menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Komuna ka rritur për 31% të hyrat vetanake krahasuar me planifikimin e këtyre të hyrave për vitin 2009. Kjo në masë të madhe ka ardhur si rezultat i rritjes të të hyrave nga lejet e ndërtimit (të cilat janë rritur për 55%), tatimi në pronë (36% rritje), shfrytëzimi i sipërfaqeve publike (31% rritje), taksa rrugore (30%) etj. Duhet theksuar se rritja e të hyrave nga tatimi në pronë ka shënuar rritje me gjithë uljen e normës së tatimit për 25% krahasuar me vitin 2008, gjë që nënkupton një rritje të efikasitetit të mbledhjes së kësaj të hyre, rritje të gatishmërisë së qytetarëve për pagimin e tatimit në pronë si dhe azhurim i të dhënave të tatimpaguesve.

Kapaciteti buxhetor i komunës për vitin 2009 është rritur nga 43,302,523 € (sa kanë mjete qenë të planifikuara në bazë të procesit të rregullt buxhetor) në 56,024,769 € që është një rritje prej 29%. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i të hyrave nga donacionet, përmes pjesëmarrjes së ministrive të linjës, USAID-it dhe Komisionit Evropian në mbështetjen e disa projekteve dhe disa mjete janë bartur nga viti paraprak për shkak të natyrës së projekteve investuese.

Janë 3,265,000 € të cilat janë siguruar jashtë buxhetit të rregullt nga buxheti qendror për këto destinime: 1.1 milion € për mbulimin e lumit Prishtina, 200 mijë € për Shkollën e Mesme të Muzikës dhe Baletit (MASHT), 100 mijë € për rregullimin e parkut në lagjen Ulpiana (MAPL), 445 mijë € për asfaltimi i rrugës Graçanicë-Laple-Sellë (Fondi kontigjent i MAPL), 100 mijë € për Hamamin e Prishtinës (Ministria e Kulturës), 200,000 € për koloninë e artistëve në Bardhosh (Ministria e Kulturës), Shkolla Speciale 300,000 € (MASHT), Shkolla fillore në Hajvali 200,000 € (MASHT), ndërtimi i kolektorit në rrugën B 470,000 € (MMPH), Qendra për punë sociale në Lagjen e Muhaxhirëve 150,000 € (MPMS). Nga Komisioni Evropian janë ndarë mjete për ndërtimin e rrugës Graçanicë-Sushicë dhe financimi i këndeve për lojërat e fëmijëve në Parkun e Qytetit dhe në Gërmë, 100,000 € Nga USAID janë ndarë 600 mijë € mjete për ndërtimin e anekseve në katër shkolla të Prishtinës dhe në ndërtimin e objektit të Shkollës së Gjellbër. Efekte të drejtpërdrejta apo anësore

rezultojnë edhe nga bashkëpunimi dhe angazhimi i KFOR-it në realizimin e disa projekteve në terren. Në bashkëpunim me KFOR-in finlandez, është realizuar projekti në vlerë prej 75.000,00 € për mbështetjen e bizneseve të vogla me makina, vegla pune dhe pajisje tjera për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Investimet kapitale

Gjatë vitit 2009, komuna ka investuar 24.2 mil € në projekte kapitale, krahasuar me 12.6 mil € në vitin 2008, që është një rritje prej 91%. Projektet më të mëdha gjatë vitit 2009 janë:

- unaza qendër - zona perëndimore, vlera 1,290,641 € (e përfunduar),
- rreth-rrotullimit dhe udhëkryqit në Arbëri, vlera 1,030,096 € (i përfunduar),
- rruga V.Fazliu - faza e dytë, vlera 2.284.103 € (e përfunduar),
- Ndërtimi i rrugës dhe kolektorit atmosferik në pjesën lindore të lumit Prishtina dhe 6 rrugëve lidhëse të Sheshi i Pajtitimit, në vlerë prej rreth 2.1 milion €

Në vitin 2009, janë asfaltuar apo shtruar me pllaka rrugë në gjatësi prej 41,9 km. Në metra katrorë, sipërfaqe të asfaltuara janë 49,238 m² ndërsa sipërfaqe të ndërtuara me pllaka 54,658 m². Janë ndërtuar kanalizime fekale në gjatësi prej 18 km dhe kanalizime atmosferike 5,4 km. Vlera kontraktuese e këtyre punimeve ka qenë 12,299,019 € Krahas kësaj, në shumë pjesë të qytetit janë zgjeruar dukshëm hapësirat e gjelbëruara.

Në fushën e arsimit, gjendja sa i përket hapësirës shkollore po përmirësohet vazhdimisht. Me investimet e vitit 2009 është rritur hapësira për nxënës nga 0.86 m² në 1.10 m². Kjo ka bërë që 90% të nxënësve të ndjekin mësimin në më së shumti dy ndërrime. Investimet kapitale në arsim mbesin një sfidë për komunën pasi numri i nxënësve në Prishtinë po rritet me mbi 4% nga viti në vit për shkak të migrimit të popullsisë në Prishtinë nga qendrat e tjera. Kjo po krijon ngarkesë në institucione shkollore dhe e shtron nevojë për trajtim preferencial të Prishtinës nga ana e institucioneve qendrore sa i përket investimeve kapitale në arsim.

Të bartura nga vitit 2008, gjatë vitit 2009 janë finalizuar 3 shkolla, qendra kulturore e fëmijëve në Gërmi (pjesa e parë), 3 terrene sportive dhe arkivi i qytetit. Po ashtu, gjatë vitit 2009 janë filluar dhe janë inauguruar 5 shkolla, 5 anekse shkollore, është restauruar hamami i qytetit (pjesa II) dhe një sallë e edukatës fizike. Kanë filluar në vitin 2009 dhe vazhdojnë në vitin 2010 edhe 5 objekte shkollore, 6 salla të edukatës fizike dhe 6 terrene sportive. Gjatë vitit 2009 janë kryer procedurat e tenderimit edhe për dy shkolla, për pjesën e dytë të qendrës kulturore të fëmijëve dhe për bibliotekën e qytetit, të cilat pritet të fillojnë në vitin 2010.

Në fushën e shëndetësisë, janë ndërtuar: 4 qendra të mjekësisë familjare (Vreshta, Velani, Ajvali dhe Arbëri) dhe 1 ambulancë shëndetësore (Sharban). Janë përfunduar punimet në QMF në Vreshtat dhe në Ajvali, kurse në fillim të vitit 2010 do të përfundojnë në Velani, Arbëri dhe në Sharban. Janë rinovuar 4 qendra të mjekësisë familjare dhe 3 ambulanca shëndetësore, janë blerë 2 autoambulanca për nevojat e qendrave të mjekësisë familjare dhe entit të ndihmës së shpejtë. Është punuar në drejtim të identifikimit të fondeve dhe investitorëve potencial për ndërtimin e spitalit të Qytetit të Prishtinës, i cili do ta përmirësonte cilësinë e shërbimeve shëndetësore për qytetarët e Prishtinës. Në këtë kontekst, janë kontaktuar shumë donatorë dhe është negociuar me Ministrinë e Shëndetësisë si dhe janë bërë hulumtimet për gjetjen e lokacionit për spital.

Gjatë kësaj periudhe është nënshkruar marrëveshja e qëllimit për partneritet me Ministrinë e Mbrojtjes së Hungarisë për ndërtimin e Kompleksit të Rekreacionit, projekt ky në vlerë paralogaritare rreth 10 milion €. Për këtë qëllim Kuvendi i Komunës ka ndarë një lokacion prej 4 hektarësh. Janë zhvilluar procedurat e prokurimit për partneritet publik-privat për ndërtimin e nënkalimit nën rrugën Bill Clinton (në pjesën veriperëndimore të katedralës) në vlerë prej 1,170,000 €. Gjatë kësaj periudhe Drejtoria e Pronës ka zhvilluar procedura për krijimin e kushteve për partneritet publik-privat për ndërtimin e Qendrës së biznesit dhe të banimit në lagjen “Dodona”. Janë bërë edhe investime të tjera kapitale të prezantuara në këtë raport sipas drejtorive.

Gjendja ekonomike dhe sociale

Në përputhje me kapacitet e saj, komuna ka mbështetur zhvillimin ekonomik përmes subvencione, involvimit në projekte me donatorë, përkrahjes së bujqve, politikave fiskale komunale, përcaktimit të zonës ekonomike për vendosjen e bizneseve etj. Sa i përket promovimit të zhvillimit ekonomik në komunë, gjatë vitit 2009 është themeluar Agjencioni Regjional për Zhvillim – Qendër, me seli në Prishtinë, në mbështetje të Komisionit Evropian. Ky agjencion po punon në përgatitjen e strategjisë regjionale të zhvillimit ekonomik dhe pritet të angazhohet intenzivisht në gjetjen e donacioneve për projekte të ndryshme të parapara në këtë strategji. Në sektorin e bujqësisë, komuna ka përkrahur bujqit me një shumë prej 217,498 € duke mbështetur të farë dhe plehra minerale, përkrahje serrave etj.

Gjatë vitit 2009, në territorin e Komunës së Prishtinës janë regjistruar 2,068 biznese të reja, krahasuar me 2,118 sa janë regjistruar në vitin 2008. Kjo ka rritur numrin e bizneseve në Prishtinë nga 21,266 sa kanë qenë në fund të vitit 2008 në 23,334 në fund të vitit 2009. Komuna e Prishtinës në vitin 2009 ka leshur 2431 leje të punës. Nuk ka të dhëna të sakta se sa prej bizneseve të regjistruara janë aktive. Sipas disa vlerësimeve, aktive mund të jenë ndërmjet 40 deri 60% të këtyre bizneseve. Kryesisht dominojnë bizneset nga fusha e tregtisë dhe shërbimeve (mbi 50% e tyre).

Sipas të dhënave të Qendrës Rajonale për Punësim në Prishtinë, numri i përgjithshëm i punëkërkuesve të regjistruar në Prishtinë në fund të viti 2009 është 19,153, prej të cilëve rreth gjysma janë femra. Megjithëse ky numër ka rënë krahasuar me vitin 2008 (kur ka qenë 19,949), vlerësohet se kjo ka të bëjë më shumë me statistikat e pasakta për shkak se shumë të papunë mund të mos regjistrohen në këto zyra. Shumica e të papunëve të regjistruar janë persona me arsim fillor dhe rreth gjysma janë të moshës 25-35 vjeç.

Numri i familjeve në asistencë sociale në komunë në vitin 2009 ka qenë 36,979 që është një rritje nga 35,437 familje sa kanë qenë në vitin 2008. Gjatë vitit 2009, komuna ka përkrahur 22 familje me kushte të rënda sociale, në shumë prej 11 mijë € për sigurimin e barnave, ushqimit ose trajtimin mjekësor. Gjatë këtij viti, Komunës i janë bashkëngjitë edhe 3 Qendra për punë sociale me 49 punëtorë. Megjithëse komuna ka kapacitete shumë të limituara për të zbutur situatën sociale, sektori i mirëqenies sociale ka përkrahë OJQ-te të personave me nevoja të veçanta dhe të sëmurët e rëndë si raste sociale përmes sigurimit të medikamenteve, trajtim mjekësorë dhe ndihmë emergjente në ushqim në shumën prej 34.681 €. Komuna në vazhdimësi është përkujdesur për 25 familjet e strehuara në kontejnerët e vendosur në Fushën e Pajtimit, duke iu mbuluar atyre familjeve shpenzimet e shërbimeve komunale dhe shpenzimet e tjera.

Ndërmarrjet publike lokale

Gjatë vitit 2009, në përputhje me Ligjin për Ndërmarrje Publike, Kuvendi Komunal dhe Kryetari i Komunës kanë zgjedhur Komisionet e Aksionarëve të këtyre ndërmarrjeve publike lokale: NP Banesore “Prishtina”, NP “Termokos”, NP “Trafiku Urban”, NP “Hortikultura” dhe NP “Sportmarketing”. Po ashtu janë kompletuar Këshillat e Drejtorëve të të gjitha këtyre ndërmarrjeve. Në përputhje me kompetencat që kanë, Këshillat e Drejtorëve në këto ndërmarrje po punojnë në kompletimin e rregullativës së këtyre ndërmarrjeve për të implementuar qeverisjen korporatave në përputhje me standardet e kërkuara. Gjatë këtij viti nuk është arritur të kompletohet komisioni i aksionarëve për NP Pastrimi, sepse me Ligj parashihet që kjo kompani të qeveriset në mënyrë korporatave nga Prishtina, Podujeva, Obiliqi, Lipjani, Fushë Kosova dhe Drenasi. Të gjitha këto komuna duhet të zgjedhin komisionet e aksionarëve, gjë që nuk është bërë deri më tani, dhe pastaj këto komisione të shpallin konkurs dhe të zgjedhin këshillin e drejtorëve.

2. MBLEDHJET E KUVENDIT, EKZEKUTIVIT DHE TRUPAVE PUNUESE

Kuvendi gjatë kësaj periudhe ka miratuar 5 rregullore dhe 44 vendime të ndryshme. Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur:

- 8 mbledhje të Kuvendit Komunal;
- 8 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa;
- 11 mbledhje të Komitetit për Komunitete;
- 8 mbledhje të Komitetit për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim;
- 6 mbledhje të Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Strehim;
- 5 mbledhje të Komitetit për Arsim Kulturë dhe Sport;
- 5 mbledhje të Komitetit për Zhvillim Ekonomik;
- 8 mbledhje të Komitetit për Shërbime Publike;
- 6 mbledhje të Komitetit për Pronë;
- 5 mbledhje të Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim;
- 3 mbledhje të Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive;
- 1 mbledhje e Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave si dhe të vendeve tjera publike të Komunës së Prishtinës.

Gjatë vitit 2009 janë mbajtur 10 tubime qytetarë: 1 tubim i përgjithshëm, 3 tubime për të shqyrtuar planet urbanistike, 5 tubime në kuadër të përgatitjeve të buxhetit për vitin 2010 dhe 1 tubim ku është diskutuar për perspektivën evropiane mbajture në Ditën e Evropës.

Sektori për shërbime të Kuvendit gjatë vitit 2009 ka kryer punët administrative rreth përgatitjes së materialeve për mbledhje të Kuvendit dhe të organeve tjera, është bashkëpunuar me drejtoritë e komunës për hartimin e rregulloreve dhe vendimeve të ndryshme, është bërë përkthimi, lekturimi dhe shpërndarja e materialeve, janë mbështetur punët e Kuvendit, Këshillit të Drejtorëve dhe të komiteteve.

3. KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS

a. Aktivitetet e kabinetit të Kryetarit të Komunës

Në vitin 2009 u realizua buxheti dhe projektet të cilat dalin nga Programi i Kryetarit të Komunës. Me prioritet ishin ndërtimet infrastrukturore, ndërtimi i shkollave për të eliminuar ndërrimin e tretë dhe të katërt, zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbëruara dhe diversifikimi dhe

rritja e efikasitetit të shërbimeve të administratës. Në këtë vit Komuna mori në përgjegjësi menaxhimin korporativ të ndërmarrjeve publike. Në vjeshtën e këtij viti u mbajtën zgjedhjet lokale, prandaj dinamika e punëve ishte dimensionuar kryesisht deri në fund të muajit shtator.

i. Qeverisja komunale dhe bashkëpunimi ndërinstitucional

Ndër aktivitetet që janë zhvilluar për qeverisjen komunale dhe bashkëpunimin ndërinstitucional janë:

- Komunikimi direkt dhe orientimi i punës me zyrtar komunal me qëllim të arritjes së objektivave punuese, është bërë në 183 raste me mbi 330 zyrtar komunal;
- Inspektimi i punës në terren është bërë në 147 raste, karakteristike është se në shumicën e vizitave inspektuese në terren janë ftuar dhe kanë marrë pjesë edhe drejtorët përkatës, përfaqësues të spektrit politik, anëtar të asamblesë dhe mediet;
- Thirrja e mbledhjeve për këshilli i Drejtorëve, Kuvendin e komunës, mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa, takimet formale dhe jo formale, ishin pjesë shumë e rëndësishme e aktiviteteve të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, ku janë mbajtur mbi 54 takime të kësaj natyre.
- Partneriteti punues dhe orientimi bashkëpunues është konkretizuar në 80 raste me institucionet vendore në nivel qendror dhe strukturat që ofrojnë shërbime rajonale, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, në këto takime kanë marrë pjesë mbi 290 përfaqësues nga partnerët në të gjitha nivelet;
- Sfide specifike gjate vitit 2009 ka qenë menaxhimi i ndërmarrjeve publike komunale dhe ndërmarrjeve publike rajonale, e cila ka ardhur si rezultat i reformave të parapara me Ligjin për ndërmarrjet publike, me qëllim të mbrojtjes së interesit të Komunës së Prishtinës, janë zhvilluar shumë aktivitete, si në fushën e organizimit të ndërmarrjeve publike komunale dhe në definimin e rolit të Komunës së Prishtinës në ndërmarrjet publike rajonale. Për këtë qëllim janë mbajtur 55 takime me rreth 184 përfaqësues;
- Partner politik strategjik për qeverisjen komunale gjate vitit 2009 janë konsideruar jo vetëm partneret formal të koalicionit por të gjitha partitë politike të përfaqësuara në asamblenë komunale, për të realizuar qeverisje sa më të mirë janë mbajtur 97 takime;
- Duke pasur parasysh se komuna e Prishtinës është kryeqytet i Republikës së Kosovës kujdes i veçantë i është kushtuar edhe bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet qendrore. Për këtë qëllim janë mbajtur mbi 125 takime;
- Prezantimi dhe përfaqësimi i qytetarëve të Prishtinës në ceremonitë dhe festat zyrtare ku ka qenë pjesë e rëndësishme e punës gjate vitit 2009, kryetari ka marr pjesë në 87 ngjarje të karakterit të tillë.

ii. Transparenca, komunikimi dhe përfshirja e qytetarëve në qeverisje

Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje dhe në jetën publik, si pjesë e rëndësishme e qeverisjes demokratike ka qenë në fokus të punës gjatë vitit 2009, sidomos po të merret në konsiderate fakti se kjo qeverisje është pjesë e rëndësishme e procesit pozitiv dhe vlerësues që duhet të marr komuna e Prishtinës në proceset integruese dhe zhvillimore. Për te arritur objektivin e një qeverisje transparente, demokratike dhe gjithëpërfshirëse është bërë punë e konsiderueshme me fokus të veçantë në këto fusha:

- Prezantimi i punës dhe marrja e mendimit dhe përfshirjes së strukturave me të veçanta në jetën publike në Prishtinë është bërë edhe në forma specifike si seminare, konferenca prezantime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit në 45 raste;

- Pritja e qytetarëve në takime është bërë edhe në formën e takimeve individuale dhe po ashtu në formën e përfaqësimeve të deleguara, janë mbajtur 225 takime, ku kanë marrë pjesë më se 850 qytetarë;
- Janë mbajtur 95 takime publike, prezantime të punës dhe pjesëmarrje në debate publike;
- Komunikimi masiv nëpërmjet medias, ka pas një kujdes të veçantë sidomos për prezantimin e politikave komunale deri të qytetarët si dhe promovimi i transparencës, kjo është bërë në 55 raste me rreth 370 përfaqësues të medias;
- Pjesëmarrja në aktivitete kulturore, si: festivale, premiera, botime apo ditë të veçanta për grupe të caktuara sociale, është bërë në 66 raste;
- Kujdes i veçantë i është kushtuar shoqërisë civile me të cilën është punuar me kujdes te veçantë dhe me përfshirjen e sajë në jetën publike. Janë mbajtur 73 takime me rreth 1150 përfaqësues të grupe të ndryshme;
- Komuniteti fetar dhe Komunitetet pakicë janë konsultuar dhe marrë në konsiderate në mënyrë të vazhdueshme Me ta janë organizuar 40 takime gjatë kësaj periudhe.

iii. Siguria publike

Pjesë e rëndësishme e punës dhe e koordinimit të aktivitetit në aspektin e sigurisë është kushtuar në koordinimin dhe harmonizimin e aktiviteteve për çështje të sigurisë me strukturat adekuate të sigurisë publike dhe të sigurisë individuale, duke u marre me elemente të sigurisë së përgjithshme dhe po ashtu edhe me çështje teknike si siguria në trafik, siguria e rrugëve, siguria e pronës, eliminimi i pikave rrezikut nëpërmjet të rritjes së shërbimeve publike dhe ofrimit të infrastrukturës komunale me të mire.

- Kryetari ka qenë i angazhuar në shumë aktivitete, koordinime dhe konsultime me organet e sigurisë vendore dhe ndërkombëtare, janë mbajtur 45 takime formale me qëllim të koordinimit të punës, dhe për krijimin e kushteve për eliminim e zonave të rrezikut, si ndërtimi apo përmirësimi i rrugëve, ndriçimi publik, koordinimi i patrullimit në zona të veçanta si shkolla apo zona të tjera.
- Organet e sigurisë kanë ofruar një ndihmë të rëndësishme në evitimin e ndërtimeve pa leje dhe të ndërmarrjes së aksioneve të përbashkëta me organet e Komunës.

iv. Zhvillimi Ekonomik

Prioritet i angazhimeve qeverisëse gjatë vitit 2009 ka qenë edhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, ku hapësirë të madhe ka zënë krijimi i parakushteve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.;

- Promovimi i investimeve për investitorët e jashtëm është trajtuar dhe konsideruar në vazhdimësi, ku janë bërë prezantime paraqitje publike dhe takime direkte me investitorët e jashtëm 74 raste me rreth 270 investitorë të mundshëm apo përfaqësues të kompanive të ndryshme të interesuar për të investuar në Prishtinë;
- Vazhdimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me institucione ekonomike dhe financiare vendore dhe ndërkombëtare që operojnë në vendin tonë, ishte prioritet i trajtuar me kujdes, në 52 takime me mbi 154 përfaqësues;
- Biznesi lokal është trajtuar me kujdes me synim që të ofrohen lehtësi dhe të nxitet zhvillimi ekonomik. Për këtë qëllim janë mbajtur 175 takime me mbi 450 përfaqësues të biznesit.

v. Bashkëpunimit ndërkombëtar

Komuna e Prishtinës ka pasur rol të veçantë edhe në skenën ndërkombëtare, përfaqësimi i Prishtinës në aspektin ndërkombëtar, komunikimi dhe realizimin i detyrimeve të veta në aspektin ndërkombëtar është realizuar me shumë sukses, si me rastin e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare po ashtu edhe në përmbushjen e detyrimeve si komune mikpritëse me rastet e vizitave të personaliteteve ndërkombëtare në Kosovë ndër sukseset që mund të përmenden janë:

- Është arritur që Prishtina të bëhet anëtare e EUROCITIES;
- Është nënshkruar Memorandumi i mirëkuptimit me Ambasadën e SHBA-së për ndërtimin e objektit të Ambasadës. Për arritje e këtij rezultati janë mbajtur shumë takime dhe aktivitete gjatë 2 viteve të fundit;
- Janë realizuar me sukses shumë punë me rastin e vizitave të personaliteteve të rëndësishme ndërkombëtare
- Janë mbajtur mbi 37 takime me rreth 123 përfaqësues të shteteve të ndryshme në Republikën e Kosovës;
- Me qëllim të përfaqësimit të Komunës dhe të qytetarëve të Prishtinës, Kryetari i Komunës ka zhvilluar rreth 10 vizita zyrtare ndërkombëtare;
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me përfaqësuesit ndërkombëtarë në Kosovë, si EULEX, ICO, OSBE, BE, BB, FMN, KE etj. Është trajtuar me kujdes të veçantë dhe janë mbajtur 64 takime me mbi 237 përfaqësues;
- Në Komunën e Prishtinës u zhvilluan 37 vizita zyrtare të përfaqësuesve politikë të nivelit lokal dhe qendror jashtë Kosovës.
- Mbi baza të binjakëzimit me Budapestin, në këtë qytet janë dërguar dy herë nga 2 zyrtarë të shërbimit civil për trajnime njëjavore në fusha me interes për Prishtinën.

vi. Kabineti i këshilltarëve të Kryetarit

Puna e Kryetarit të Komunës është mbështetur nga Kabineti i këshilltarëve dhe nga Këshilli i Ekspertëve për Urbanizëm. Aktivitetet janë shtrirë në fusha të ndryshme si: urbanizëm, zhvillim ekonomik dhe integritet evropian, për pushtetin lokal dhe organizatat ndërkombëtare dhe për informim. Një qasje më moderne në aspektin urban ka luajtur edhe Këshilli i ekspertëve për urbanizëm i përbërë nga 11 ekspertë të fushave të ndryshme.

vii. Kërkesat zyrtare të drejtuar në zyrën e Kryetarit:

Zyra e Kryetarit ka pranuar mbi 978 kërkesa për trajtime të ndryshme. Të gjitha rastet janë dërguar të organet kompetente për procedim.

b. Aktivitetet e zyrave

i. Zyra e prokurimit

Gjatë vitit 2009, në bazë të kërkesave të Drejtorive janë kontraktuar punë, furnizime, shërbime dhe projekte e në shumën prej 26,776,980 € Janë zhvilluar 317 aktivitete të prokurimit dhe prej tyre janë kontraktuar 221 aktivitete të vlerave të mëdha, të mesme dhe të vogla si dhe 55 aktivitete me vlera minimale (nën 1000 €). Gjatë kësaj periudhe ka pasur 35 anulime kryesisht për shkak të mungesës së tre operatorëve ekonomik të përgjegjshëm si dhe 6 aktivitete kanë qenë në procedurë deri më datë 31.12.2009.

Mbi 82 % e prokurimeve kanë të bëjnë me investime kapitale. Te furnizimet, pozicioni më i rëndësishëm dhe më i madh është furnizimi me naftë për ngrohje për shkolla. Llojet e aktiviteteve të prokurimit të kontraktuara dhe në procedure janë si në vijim:

-Pune – projekte kapitale	21,982,270	82.10	%
-Furnizime me mallra,	3,284,164	12.26	%
-Shërbime dhe projekte	1,510,546	5.64	%
-Koncesione në 2 raste			
- auto-parkingu te Pallati i Rinisë *			
- dhe Nënkalimi te KEK-u) **	-	-	-
Gjithsej	26,776,980	100	%

* Të hyrat mujore që përfiton komuna nga ky koncesion janë 11,000 €,

** Investimi i prituri nga ana e kompanisë që ka fituar tenderin 1,170,000 €, 11,000

Rreth 95% e prokurimeve të kontraktuara apo që janë në procedure kanë kaluar përmes procedurës së tenderit publik. Procedurat e aplikuara janë paraqitur në vijim:

-Procedurë e hapur	25,424,372	94.95	%
-Aprovime nga APP dhe negociimet	952,899	3.56	%
-kuotime	363,291	1.36	%
-Vlera minimale nën 1000 €	36,416	0.13	%
Gjithsej	26,776,978	100	%

Rreth 50% e punëve, furnizimeve dhe projekteve të kontraktuara kanë qenë me vlerë të madhe dhe gati po aq me vlerë të mesme. Përqindjet për kuotime dhe vlera minimale janë pothuaj të pa përfillshme. Kontratat sipas vlerave:

-Vlera e madhe	13,257,777	49.51	%
-Vlera e mesme	13,119,494	48.99	%
-kuotime	363,291	1.36	%
-Vlera min. nën 1000 €	36,416	0.14	%
Gjithsej	26,776,978	100	%

Gjatë vitit 2009, në 7 raste operator ekonomik kanë ushtruar ankesa kundër vendimeve të Departamentit të Prokurimit dhe në gjashtë raste OSHP i ka aprovuar zgjedhjet që i ka propozuar komuna, ndërsa në një rast nuk e ka aprovuar zgjidhjen e komunës. Megjithatë, në fund kontrata e aprovuar nga OSHP ka dështuar për shkak se kompania ankuuese ka dale të jetë jo serioze në përmbushjen e kushteve të kontraktuara. Departamenti i prokurimit në bazë të raporteve zyrtare të organeve mbikëqyrëse dhe komisioneve të pranimit, ju ka shqiptuar dënime operatorëve ekonomik të pa përgjegjshëm për vonesa në kryerjen e punëve dhe ka marrë masa tjera konform Ligjit në fuqi. Në vijim janë projektet më të rëndësishme kapitale të kontraktuara gjatë vitit 2009, ku vlera e secilit prej tyre është mbi një milion € (i) unaza qendër - zona përfundimtare, vlera 1.290.641 € (i përfunduar), (ii) rreth-rrrotullimit dhe udhëkryqit në Arbëri, vlera 1.030.096 € (i përfunduar), (iii) rruga V.Fazliu - faza e dytë, vlera 2.284.103 € (i përfunduar), (iv) rruga dhe kolektorit atmosferik, vlera 1.589.402 € (në fazën përfundimtare).

ii. Zyra për marrëdhënie me publikun

Zyra për Marrëdhënie me Publikun (ZMP) në Komunën e Prishtinës çdo ditë kontaktohet dhe kontakton mediat e shkruara dhe elektronike që veprojnë në Prishtinë, sipas përcaktimit për veprimtari pro aktive, si dhe ka raportuar rregullisht për punët dhe aktivitetet e Komunës

së Prishtinës. Janë përcjell të gjitha takimet protokollare të kryetarit të komunës, mbledhjet e Kuvendit Komunal, të Këshillit të Drejtorëve, dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe përmes komunikatave për media është informuar opinioni publik. Zyra për Marrëdhënie me Publikun ka distribuuar për media numër të madh informatash, lajme, ftesa, komunikata, reagime dhe kumtesa për opinion, të cilat janë plasuar edhe në faqen e internetit të Komunës së Prishtinës dhe në intranet. Gjatë vitit 2009 nga ZMP-ja janë organizuar konferenca për media, të cilat janë përcjell nga pothuajse të gjitha mediat elektronike dhe të shkruara. Po ashtu ZPMP-ja ka qenë pjesë e organizimeve të ndryshme si debateve publike, përrurimeve, inaugurimeve dhe promovimeve të ndryshme. Është bërë akreditimi i gazetarëve që mbulojnë aktivitetin e komunës së Prishtinës. ZPMP-ja ka bashkëpunuar me Asociacionin e komunave, OJQ-të, KFOR-in, OSBE-në, dhe institucionet tjera vendore.

Në kuadër të punës së saj të përditshme, kjo zyrë përcjell vazhdimisht shtypin ditor dhe mediat elektronike, dhe ka veçuar tekstet në faqet e gazetave ku shkruhet për komunën e Prishtinës, duke i ruajtur dhe arkivuar ato. Përveç punëve të përditshme, kjo zyrë është përkujdesur edhe për funksionimin e ueb-faqes së Komunës së Prishtinës. Është ri-dizajnuar dhe plotësuar me materiale ueb-faqja e Komunës. Krahasuar me vitin e kaluar, kjo zyrë ka pasur vëllim më të shtuar të punëve të gjitha fushat. Komunës së Prishtinës, i është rezervuar hapësirë e kënaqshme në televizionet nacionale dhe kabllore, dhe në të gjitha gazetat ditore, për t'i plasuar të arriturat dhe aktivitetet. Janë mbuluar nga mediat përgjithësisht të gjitha aktivitetet e kryetarit dhe të këshillit të drejtorëve: rrënimet e objekteve pa leje, largimi i shitësve ambulant, rregullimi i infrastrukturës rrugore, shkollore, shëndetësore, shtimi i hapësirave publike.

iii. Zyra e përfaqësimit juridik

Funksioni dhe kompetencat e kësaj zyre janë përcaktuar dhe janë rregulluar me Ligjin për Avokaturën Publike. Detyrë themelore ishte përfaqësimi i Komunës në gjykata dhe në institucionet tjera publike me qëllim të mbrojtjes së interesit juridik dhe pasuror të Komunës. Në kuadër të këtij aktiviteti Zyra e Avokaturës Publike, gjatë periudhës raportuese janar - dhjetor 2009 ka pranuar gjithsej 243 lëndë, të ndryshme si vijon: lëndë civile të natyrës pronësore-juridike 136, lëndë nga marrëdhënia e punës 15, lëndë administrative 60, lëndë të natyrës penale 10, lëndë të natyrës jashtë-kontestimore 22. Gjatë periudhës raportuese janë përfunduar (zgjidhur) gjithsej 54 lëndë, ndërsa të tjerat janë në procedurë. Nga numri i lëndëve të përfunduara (gjithsej 54), në favor të Komunës kanë përfunduar 31 lëndë. Zgjidhja e suksesshme e lëndëve në favor të Komunës në këtë vit i referohet kryesisht ndryshimeve kadrovike që kanë ndodhur në këtë shërbim.

iv. Zyra ligjore

Gjatë vitit 2009, zyra ligjore ka vazhduar me dhënien e këshillave, informacioneve për ekzekutivin, sektorët/zyrat, institucionet e arsimit dhe të shëndetësisë dhe ndërmarrjet publike komunale. Zyra ligjore është marrë edhe me shqyrtimin e të gjitha propozimvendimeve dhe rregulloreve, të cilat i janë dërguar zyrës nga ana e drejtorëve të drejtorive, të drejtorëve të institucioneve arsimore, shëndetësore dhe të ndërmarrjeve publike lokale. Me qëllim të zbatimit të Ligjit 03/L-04 për Vetëqeverisje Lokale, zyra ka punuar në në hartimin e Statutit të Komunës së Prishtinës, të Rregullores për përdorimin e gjuhëve, Rregulloren për transparencë dhe akte të tjera të lidhura me kompetencën e Komunës. Zyrari ligjor ka marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës, pjesëmarrje në grupe punuese për hartimin e vendimit për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, pjesëmarrje në takime të

ndryshme në Shqipëri, Maqedoni dhe në komunat tjera të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me nivelin komunal, pjesëmarrje në grupet e caktuara për miratim të: Rregullores për taksën në pronë dhe Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale, pjesëmarrje në grupe punuese në nivel të Qeverisë së Kosovës, etj. Zyra ka përpiluar kontratat për shfrytëzim të tokës/objekteve, në pajtim me vendimet e miratuara në Kuvendin e Komunës, ka ofruar këshilla juridike me, komente, hartimin e vendimeve, publikimin e konkursit për zyrtar të ndërmarrjeve publike dhe ndihmë tjetër në aplikim të dispozitave të Ligjit për ndërmarrjet publike.

v. Zyra për integritet evropian

Në vitin 2009, Zyra i ka realizuar aktivitetet si vijon: (i) janë organizuar takime të rregullta nga Kolegjiumi i Zyrtarëve Komunal për Integritet Evropian, në mbështetje nga EYG (organizatë joqeveritare) dhe Agjensioni për Integritet Evropian në kuadër të MAPL-së. Takimet janë mbajtur nëpër të qytetet të ndryshme të Kosovës (Shtime, Ferizaj, Pejë, Prishtinë dhe Durrës). Në këto takime janë diskutuar problemet e ndryshme që lidhen me implementimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE). Nga gjithsej rreth 1,600 aktivitete që dalin nga PVPE, për komuna janë specifikuar rreth 170 aktivitete që bien direkt në linjë të përgjegjësisë së komunave; (ii) më 8 prill 2009 Zyra ka marrë pjesë në takimin e kolegjiumit të zyrtarëve për integritet evropian në Shtime për të diskutuar implementimin e PVPE-së; (iii) më 28 Prill 2009, Bordi i Kolegjiumit ka mbajtur takimin e rregullt punues në Ferizaj. Në këtë takim janë diskutuar dhe është arritur pajtimi për aktivitetet që do të organizojnë komunat në lidhje me shënimin e Ditës së Evropës, më 9 maj; (iv) më datë 30 Qershor 2009, është mbajtur trajnimi për ZIE, organizuar nga MAPL. Çështje e diskutimit ka qenë procesi i monitorimit dhe raportimi për PVPE; (v) më 16 Dhjetor 2009 është mbajtur takimi përmbyllës, i organizuar nga MAPL, gjegjësisht ZIE. Me theks të veçantë janë diskutuar vështirësitë dhe mos raportimet e disa komunave me kohë; (vi) ZIE në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, Kulturës dhe Sportit ka organizuar aktivitetet për shënimin e Ditës së Evropës më datë 9 maj 2009. Për aktivitetet komunale që dalin nga PVPE, zyrtari komunal për integritet evropian ka raportuar në baza tre mujore në MAPL.

vi. Zyra për auditim të brendshëm

Gjate vitit 2009 njësia e auditimit të brendshëm dhe stafi i njësisë kanë zhvilluar aktivitete të ndryshme audituese në fusha të ndryshme. Ka vepruar edhe Komiteti i Auditimit, i cili ka aprovuar planin e auditimit të brendshëm dhe ka diskutuar për raportet e auditimit. Në vitin 2009 zyra ka audituar Drejtorinë e Arsimit ku janë dhënë 29 rekomandime me qëllim që të ndihmojnë menaxhmentin e drejtorive të caktuara që të ngritin efikasitetin e menaxhimit me paratë dhe pronën publike. Po ashtu gjate këtij viti njësia e auditimit ka ofruar edhe disa shërbime të konsulences për Drejtorinë e Arsimit, Drejtorinë e Pronës dhe Sektorin e kontabilitetit. Gjate vitit 2009 zyrtarët e auditimit kanë marrë pjesë në diskutimet për ndryshimin e ligjit të auditimit të brendshëm si dhe udhëzimeve dhe akteve të tjera për auditim. Po ashtu, gjate vitit 2009, zyra ka bashkëpunuar me auditorët e zyrës së auditorit gjeneral për dy auditimet të cilat janë bërë nga zyra e auditorit gjeneral në Komunën e Prishtinës.

Gjate vitit 2009 zyrtarët e auditimit kanë marrë pjesë në disa trajnime dhe kanë bashkëpunuar me auditorët e zyrës së auditorit gjeneral Kosovës.

vii. Njësia për të drejtat e njeriut

Kjo njësi, që nga viti 2008 po implementon projektin e "Qendrës Informative për Gratë" në bashkëpunim me OJQ-të e zonave rurale të Prishtinës. Në kuadër të këtij projekti janë mbajtur shumë takime dhe tryeza me gratë e viseve rurale për të diskutuar problemet me të cilat ballafaqohen ato. Ndër tryezat e organizuara ka qenë ajo me temën "Paqes i duhen grat, e grave ju duhet drejtësia" janë diskutuar ligji i punës, ligji për familje dhe ligji për trashëgiminë. Janë organizuar ligjërata për barazinë gjinore, tryeza për dhunën mbi baza gjinore dhe legjislacionin përkatës etj. Njësia për të drejtat e njeriut ka marrë pjesë rregullisht në takimet e Agjencionit për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeminsitrit, ka punuar ngushtë me grupin për hartimin e planit lokal për personat me aftësi të kufizuara, ka marrë pjesë në takimin për të drejtat e pakicave, ka organizuar debatin për raportin nxënës-arsimtar më datë 7 mars, ka marrë pjesë në takimet e ditës ndërkombëtare të fëmijëve më 1 qershor, ka organizuar mbledhje solemne të asamblesë komunale të fëmijëve më 28 nëntor, ka organizuar ligjëraten për leadership për nxënës të shkollave si dhe orë letrare, debati për vetëdijesim kundër HIV-AIDS-it dhe zyrtarët kanë marrë pjesë në shumë takime të tjera ku janë diskutuar çështje brenda fushë-veprimtarisë së kësaj njësie.

viii. Zyra për kthim

Gjatë vitit 2009 nuk është regjistruar asnjë ekses ndër etnik në territorin e Komunës së Prishtinës. Komunitetet minoritare kanë pasur qasje të plotë në shërbimet publike në të gjitha institucionet komunale. Gjatë vitit 2009 janë realizua 47 takime me zyrtarët e OSCE-së lidhur me aktivitetet e zyrës komunale për kthime dhe për punën e zyrtarëve të Zyrës së Komuniteteve në Graçanicë. Në këto takime është diskutuar edhe për projektet e ndryshme, infrastrukturën, arsimin, shëndetësinë, çështjet ekonomike, sociale dhe sigurisë dhe çështjet e kthimit në mjediset ndëretnike. Zyra është angazhuar rreth kthimit të të zhvendosurve, pajisjen e tyre me dokumentacion personal e pronësor si dhe në hartimin e strategjisë komunale për kthim.

Gjatë vitit 2009 me zyrtarët e UNHCR-ës dhe KAAD janë organizua 28 takime lidhur me kërkesat e të zhvendosurve për kthim, kthimi i të zhvendosurve serbë në Kolovicë, kërkesat dhe gjendja e komuniteteve, gjendjen e familjeve serbe të cilët jetojnë në qytetin e Prishtinës, takimet informative për përgatitjen e vizitave para vizitave shtëpive dhe pronave të të zhvendosurve dhe të kthyerve etj. Gjatë vitit 2009 zyrtarët për kthime kanë marrë pjesë 11 takime të Komitetit për Komunitete. Nga UNDP dhe UNHCR janë ndërtuar/riparuar dhe janë në proces të ndërtimit shtëpitë e gjashtë familjeve të të kthyerve dhe të zhvendosurve serbë. Gjatë këtij viti, po ashtu, janë organizua 6 takime me këshillin qeveritar lidhur me strategjinë për kthim 2010/2013, strategjia për komunikim, doracaku për kthim të qëndrueshëm, projekt buxheti i Ministrisë për Kthim dhe Komunitete për 2010, takimet regjionale koordinuese, përkrahja dhe ndihma në procesin e kthimit. Zyra ka organizuar 5 vizita në terren ku kanë marrë pjesë 22 serbë, 14 ashkali dhe 13 romë, të cilët kanë vizituar shtëpitë dhe pronat e tyre në territorin e Komunës së Prishtinës.

ix. Zyra për komunitete

Projektet më të rëndësishme infrastrukturore që janë realizuar gjatë vitit të mëparshëm 2009 kanë qenë: Punimi i rrjetit të kanalizimit në Preocë (bashkë financuar me KFOR-in), dezinfektimi, dezinsketimi dhe deratizimi i objekteve shkollore dhe të sipërfaqeve të tjera të hapura në Graçanicë, ndërtimi i një pjese të rrugës Graçanicë – Llapjesellë, pastrimi i deponive të egra, i plerave, punimi i vend parkimit para Shtëpisë së kulturës në Graçanicë,

punimi i kanalizimit në Graçanicë dhe Lapje sellë, asfaltimi i rrugës në Kishnicë dhe në lagjen e romëve, sanimi i rrugicave lokale në Graçanicë dhe rrethinë si dhe ndërtimi i urrës në Prekovic, rregullimi i rrugës së romëve në Graçanicë, ndërtimi dhe montimi i shtyllave të trafo stacionit në mes të Graçanicës dhe Ajvalis, asfaltimi i rrugëve lokale, punimi i trotuareve dhe pastrimi i lumit (i ndërprerë për shkak të dimrit), punimi i kanalizimit në Sushicë në bashkëfinancim me KFOR-in (është në realizim e sipër). Janë zhvilluar edhe projekte tjera brenda Prishtinës në bashkësitë tjera joshqiptare të cilat kanë pasur për qëllim përmirësimin e kushteve jetike për të gjitha bashkësitë etnike .

Të gjitha shërbimet e inspektimit kanë punuar në kryerjen e të gjitha detyrave të punës si vizita e terreneve për pengimin e shitësve në rrugë në vende të ndaluara dhe në trotuare, vërtetimi i lokaleve për mos tejkalimin e orarit të punës etj. Shërbimi për zhvillim ekonomik në Graçanicë ka realizuar projekte për zhvillimin e bujqësisë ekzistuese duke zbatuar risitë në procesin e prodhimit dhe duke nxitur ekonominë e vogël dhe të mesme përmes donacioneve. Në sektorin e arsimit të ZKB në Graçanicë është punuar në nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet drejtorit të institucioneve edukativo-arsimore dhe Drejtorisë për arsim të Komunës së Prishtinës, si dhe transporti aktiv i nxënësve në dy relacione Prekovic – Graçanicë dhe Brnjicë e epërme – Graçanicë. Aktivitetet në lami të kulturës kanë qenë të llojllojshme të realizuara kryesisht përmes Shtëpisë së Kulturës në Graçanicë.

4. DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT

a. Sektori i punëve të përgjithshme dhe juridike

Gjatë viti 2009, ky sektor ka kryer punët siç janë: rregullimi, sistemimi dhe ruajtja e dokumentacionet të shërbyesve civilë, janë përpiluar kontrata të punës, janë përgatitur vendime për pushime vjetore dhe të tjera etj. Në evidencat e shërbimit për marrëdhënie pune (gjendja më 31 dhjetor 2009) kanë qenë të regjistruar 654 shërbyes civilë, krahasuar me 680 sa kanë qenë në vitin 2008, që është për 26 shërbyes civilë më pak, ose zvogëlim prej 4%. Struktura kualifikuese e shërbyes civilë është si vijon: përgatitja superiore (fakulteti) 172 (26%); përgatitja e lartë (shkolla e lartë) 46 (7%); përgatitja e mesme 410 (63%) dhe përgatitja e ultë 26 ose 4%.

Gjatë vitit 2009, marrëdhënia e punës iu është ndërprerë 40 shërbyesve civil, sipas këtyre bazave: janë pensionuar 10 shërbyes civilë; e kanë lëshuar punën me vetë dëshirë 16 shërbyes civilë; kanë vdekur 2 shërbyes civilë dhe në bazë të marrëveshjes (kontratës) ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe MSS “Mobile Sanitary Services”, 12 shërbyes civilë që kanë qenë të angazhuar në mbajtjen e pastërtisë në objektin e komunës kanë kaluar në këtë të fundit. Gjatë periudhës raportuese janar – dhjetor 2009 janë shqiptuar masa të ndryshme disiplinore kundër 10 shërbyesve civilë. Gjatë vitit 2009 janë pranuar në punë 14 shërbyes civil.

b. Sektori i bashkësive lokale

Në kuadër të këtij sektori funksionojnë gjithsej 36 bashkësi lokale, 20 prej të cilave i takojnë zonës urbane, ndërsa 16 të tjera bëjnë pjesë në zonën rurale. Gjatë periudhës raportuese është bashkëpunuar me drejtoritë e Komunës për realizimin e projekteve të ndryshme nga lëmi i infrastrukturës. Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë organizuar tubime me qytetarë në disa bashkësi lokale lidhur me nevojat e tyre. Zyrat e bashkësive lokale kanë kryer shërbime administrative të ndryshme, ku sipas kërkesave të palëve janë lëshuar gjithsej 70,434 vërtetime të ndryshme si vërtetime për rregullimin e dokumentacionit personal, të drejtave në asistencë sociale, të drejtave të qytetarëve që përkohësisht jetojnë dhe punojnë në botën e jashtme etj.

c. Sektori teknik

Në kuadër të këtij sektori, janë kryer këto punë dhe detyra: është bërë sigurimi dhe mirëmbajtja e objekteve të Komunës, përfshirë këtu edhe mirëmbajtjen e objektit të ri të Komunës në lagjen “Arbëria”; është bërë mirëmbajtja e teknologjisë informative dhe e rrjetit telefonik brenda objekteve të Komunës; është bërë ngjyrosja dhe rregullimi i disa zyrave brenda objektit të Komunës; është bërë mbikëqyrja për mënyrën e shfrytëzimit të automjeteve të Komunës, është mbajtur evidencë për numrin e kilometrave të kaluara si dhe për sasinë e shpenzimit të karburanteve.

Gjatë vitit 2009, janë shënuar kursime të konsiderueshme në shpenzimet e karburantit dhe të telefonisë fikse në komunë siç janë dhënë në vijim:

- Gjatë vitit 2009, nga gjithsej 45 automjete, gjatë kryerjes së punëve zyrtare janë shënuar gjithsej 422,233 km të kaluara, ndërsa gjatë vitit 2008 nga numri i njëjtë i automjeteve janë shënuar 450,351 km të kaluara, që është për 28.118 km ose 6% më pak.
- Sa i përket shpenzimit të karburanteve, gjatë vitit 2009 nga automjetet e Komunës janë harxhuar 57,445 litra të karburantit, ndërsa gjatë viti 2008 janë harxhuar 61,486 litra karburante, që është për 4,041 litra ose 7% më pak.
- Shpenzimet e telefonisë fikse të Komunës, për vitin 2009 kanë qenë 33.529,74 € ndërsa për periudhën e njëjtë të vitit 2008 këto shpenzime kanë qenë 39.727,48 € që nënkupton se shpenzimet e telefonisë fikse për periudhën raportuese 2009 kanë qenë për 6.197,74 € ose 16% më pak se në të njëjtën periudhë të vitit 2008.

d. Sektori i gjendjes civile

Aktivitet i përhershëm i këtij sektori është pranimi, shqyrtimi, regjistrimi, mirëmbajtja dhe sistemimi i lëndëve, të parashtruara nga palët nga lëmi i gjendjes civile, siç janë rastet e lindjeve, rastet e martesave, rastet e vdekjeve etj.

Në vitin 2009 me qëllim shtimin e efikasitetit, eliminimin e radhëve në pritje si dhe ofrimin e shërbimeve më afër qytetarëve, janë hapur katër zyra të oficerisë në lagjen Ulpiana, Dardania, Taslixhe dhe në lagjen Kodra e Trimave. Hapja e këtyre zyrave ka ndikuar ndjeshëm në zvogëlimin e numrit të palëve në objektin kryesor të Komunës. Gjatë periudhës raportuese në kuadër të këtij sektori janë realizuar këto punë dhe detyra:

- janë lëshuar 105.945 certifikata të lindjes (51,188 më shumë se në vitin 2008);
- certifikata martesore 19,399 (7,348 më shumë se në se në vitin 2008);
- certifikata të vdekjes 4,251 (4,233 më pak se në vitin 2008);
- certifikata të statusit martesor 5,167 (1,751 më shumë se në vitin 2008);
- certifikata që personi jeton 553 (530 më pak se në vitin 2008);
- certifikata të shtetësisë 12,638;
- certifikata të vendbanimit 187;
- deklarata të bashkësisë familjare 4,594 (508 më pak se në vitin 2008);
- deklarata të vërtetuara me dëshmitarë 178;
- janë vërtetuar 48,599 dokumente të fotokopjuara, në bazë të dokumenteve origjinale të prezantuara nga palët.

e. Zyra pritëse

Përmes zyrës pritëse janë pranuar 34,437 lëndë të grupuara sipas drejtorive/zyreve, të prezantuara në pasqyrën në vijim.

Pasqyra 1. Lëndët e pranuar në vitin 2010 (Zyra pritëse)

DREJTORITË	Pranuara	Refuzuar	Miratuar	Hedhura poshtë	Njoftim	Informim	Përgjigje	Kushte urbanistike	Leje ndërtimi	Konkluzë	Pakryera
1. Administrata	2474	14	2366	19	1	2	-	-	-	-	72
2. Shëndetësi dhe mirëqenie sociale	1197	245	858	-	91	2	1	-	-	-	-
3. Arsim dhe kulturë	1179	220	665	-	102	3	161	-	-	-	28
4. Financa Ekonomi dhe zhvillim	18853	437	17872	87	31	5	-	-	-	-	421
5. Urbanizëm, Kadastër dhe mbrojtjes së mjedisit	7395	197	5104	45	236	521	33	192	61	7	999
6. Infrastrukturë Lokale	374	-	38	-	288	4	2	-	-	-	42
7. Shërbime publike dhe Emergjencë civile	2658	1	2002	2	460	3	2	-	-	-	188
8. Pronë	305	-	30	-	41	7	2	-	-	-	225
9. Auditimi i brendshëm	2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2
Gjithsejtë :	34437	1114	28935	153	1250	547	201	192	61	7	1977

Nga të dhënat rezulton se kanë mbetur të pakryera 5.7% e lëndëve të pranuar ose 1,977 lëndë nga gjithsej 34.437 sosh.

Ndërsa në librat e shënuar më poshtë janë pranuar 12,404 lëndë si në vijim.

- Vërtetime mbajtës familje, dhe ndihmë juridike 902
- Libri i ekspedicionit në vend 1969
- Libri i dorëzimit të postës personalisht 1710
- Libri i faturave hyrëse 1022
- Libri i Protokollit (konkurse, D.Z, etj) 5236
- Libri i Protokollit (social) 1565

Në Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit nëpërmes librave të evidencës janë pranuar..... 32541 lëndë.

Gjithsejtë lëndë të pranuar dhe të përcjella nga Zyra Pritëse për vitit 2009 janë 46,841 që është për 1% më shumë se në vitin 2008.

f. Zyra për teknologji informatike

Zyra për teknologji informatike, gjatë vitit 2009 ka udhëhequr dhe kontrolluar punën e sistemit të teknologjisë informatike me qëllim të zbatimit të standardeve dhe ofrimit të shërbimeve sa me cilësore dhe shpërndarjes së informimit mbi teknologjinë informativk. Ka bërë mirëmbajtjen e infrastrukturës për internet / intranet, shtrirjen e kablllove, kyçjen e tyre në kabinetet e sëitch-ave dhe përcaktimi i porteve. Ka krye shërbime softuerike dhe harduerike, ndihma për shfrytëzuesit komunal për zgjedhjen e problemeve si: instalimi dhe konfigurimi i sistemeve operative, programeve aplikative, printerëve etj.; konfigurimi i kompjuterëve për operim funksional në rrjetë; identifikimi dhe zgjidhja e problemit të sistemit operativ; identifikimi dhe zgjidhja e problemeve harduerike; identifikimi dhe

zgjdhja e problemeve në rrjetin lokal (LAN). Është kujdesur për siguri në teknologji informative, në rrjeta, aparate, sisteme dhe programe të cilat punojnë dhe ruajnë të dhëna të ndjeshme. Është bërë kontrollimi dhe mbikëqyrja e sistemit, vlerësimi i rreziqeve, zbulimi, raportimi dhe ballafaqimi me incidentet e dyshuara të sigurisë në teknologji informatike. Është mirëmbajtur softueri i intranetit; janë regjistruar punëtorët, mirëmbajt sistemi i postës elektronike (lokale), është mirëmbajt menaxheri i fajllave, është bërë menaxhimi i bazave të shënimeve. Është bërë caktimi i të drejtave të shfrytëzuesve të intranetit në bazë të obligimeve që kanë ata brenda për brenda komunës.

5. DREJTORIA E EKONOMISË, FINANCAVE DHE ZHVILLIMIT

a. Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore

Të hyrat buxhetore për vitin fiskal 2009 kanë arritur në nivelin prej 18,337,165.13€ duke tejkaluar për 31% të hyrat e planifikuara prej 14,000,000€ për këtë vit (shih tabelën në vijim). Të hyrat buxhetore kanë shënuar rritje më të madhe (mbi realizimin) në krahasim me planin në këto fusha:

- a) Leje ndërtimi.....55%
- b) Tatimi në pronë.....36%
- c) Taksa rrugore.....30%
- d) Shfrytëzimi i sipërfaqeve publike.....31%

Pasqyra 2: Planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake Janar - Dhjetor 2009

Nr.	Përshkrimi	Planifikimi	Realizimi	% e realizimit
1	Administrata	160,000	256,345	160%
2	Të hyra nga kadastri	600,000	429,330	72%
3	Të hyra nga inspekcioni	145,000	103,423	71%
4	Shfrytëzimi i sip. publike	600,000	786,586	131%
5	Transaksioni i pronës	730,000	701,883	96%
6	Licenca në biznes	700,000	590,280	84%
7	Leje ndërtimi	5,655,000	8,756,843	155%
8	Tatimi në pronë	3,100,000	4,209,511	136%
9	Arsim	800,000	864,374	108%
10	Shëndetësi	200,000	175,917	88%
11	Taksa rrugore	300,000	389,322	130%
12	Të hyra trafik	900,000	726,012	81%
13	Participime / Donacione	50,000	35,939	72%
14	Të hyra tjera	60,000	804	1%
15	Agjensioni i pyjeve	-	1,521	-
16	Gjobat nga gjykatat	-	309,074	-
G j i t h s e j		14,000,000	18,337,165	131%

Rezultate të mira janë shënuar edhe në arkëtimin e tatimit në pronë, megjithëse normat e tatimit në pronë në vitin 2009 janë ulur për 25% krahasuar me vitin 2008. Efektet e rritjes së të hyrave nga tatimi në pronë vlerësohen të jenë nga zgjerimi i bazës tatimore, përkatësisht rritja e numrit të atyre që kryejnë obligimet tatimore.

Në vlera absolute, buxheti i komunës i aprovuar për vitin 2009 ka qenë 43,302,523 € Kësaj shume i janë shtuar edhe 12,722,246 € nga donatorët e ndryshëm për projekte të ndryshme, mjete nga ministritë e linjës si dhe mjete të bartura nga viti paraparak për shkak të natyrës si disa projekteve. Kjo ka rritur buxhetin për vitin 2009 në 56,024,769 €

Në raport me planin buxhetor, shpenzimet janë realizuar në nivel prej 85% ose 47,699,886 € Të dhënat për realizimin e buxhetit për vitin 2009 sipas kategorive janë si vijon:

Pasqyra 3: Planifikimi dhe realizimi i buxhetit (Janar -Dhjetor 2009)

Nr.	Përshkrimi	Planifikimi	Realizimi	% e realizimit
1	Paga&Mëditje	15,236,112.42	15,139,081.23	99.36
2	Mallra&Shërbime	6,671,774.79	5,074,858.67	76.06
3	Shpenzime Komunale	2,703,872.00	2,703,116.27	99.97
4	Investime Kapitale	30,823,640.94	24,201,876.98	78.52
5	Subvencione & Transfere	589,369.02	580,953.47	98.57
Gjithsej		56,024,769.17	47,699,886.62	85.14

Përqindja e realizimit të mallrave dhe shërbimeve në nivel prej 76.06% është e tillë për shkak se disa prej shërbimeve të mirëmbajtjes janë në kontinuitet sipas projekteve, duke rezultuar me bartjen e mjeteve buxhetore nga viti në vit, gjithnjë sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik. Shpenzimet buxhetore sipas programeve janë realizuar si vijon.

Pasqyra 4: Shpenzimet buxhetore sipas programeve

	Administrata e Përgjithshme	Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
Paga dhe mëditje	99.43%	99.72%	99.26%
Mallra dhe shërbime	68.99%	73.32%	89.06%
Shpenzime komunale	100.00%	99.78%	99.99%
Investime kapitale	80.98%	47.55%	73.16%
Subvencione dhe transfere	98.57%	99.33%	100.00%
Gjithsej	82.03%	81.29%	92.47%

b. Sektori për buxhet dhe financa

Ky sektor ka përmbushur këto detyra: përgatitja e raporteve periodike financiare, përgatitja e Pasqyrës Financiare për vitin 2008, përgatitja e listës së projekteve me ridestitim dhe për bartje të buxhetit në vitin 2009, nënshkrimi i të gjithave pagesave-transaksioneve financiare (Administratë, Arsim, Shëndetësi, Zjarrfiksa dhe ZLK), zotimi i mjeteve dhe plotësimi i formularëve në sistemin Free Balanc, Janar-Dhjetor/2009, pranimi dhe regjistrimi i faturave, kontimi i të gjitha urdhëresave prej në programin softuerik, regjistrimi i të hyrave nga inkasimi ditor, regjistrimi i të hyrave vetanake në sistemin Free Balancë dhe programin softverik, barazimet mujore me Departamentin e Thesarit-MEF, pranimit dorëzimi i parasë së imët në arkë dhe regjistrimi në ditarin e arkës, pagesa e faturave të imëta me para të gatshme, kontimi i pagave, plotësimi dhe ndryshimi i llogaritjës së të ardhurave personale-dërgimi në MSHP, alokimi i të hyrave dhe balancimi i tyre me shpenzimet, përgatitja e projekt propozim buxhetit për vitin 2010-2012, ofrimi i shënimeve për ekipin e zyrës së auditorit gjeneral, regjistrimi i inventarit të Komunës, certifikimi i bartja e kompetencave për menaxhimin e shpenzimeve nga ana e Thesarit-MEF dhe punë të tjera sipas kërkesës së menaxhmentit.

c. Sektori i tatimit në pronë

Gjatë vitit 2009 janë kryer këto punë sipas planit të këtij viti: janë bërë ndryshime të destinimit për të gjitha objekte te regjistruara, është nxjerr gjendja për 15.750 obligues tatimor, është bërë regjistrimi dhe ruajtja në kompjuter e të gjitha objekteve të regjistruara gjat vitit tatimor, është bërë regjistrimi i formularëve te objekteve te regjistruara ne teren për 2010 objekte te reja, janë shtypur vërejtje të fundit të pagimit e tatimit në pronë rreth 1700 etj. Inkasimi i tatimit në pronë gjatë kësaj periudhe ka qenë në vlerë prej 4.209.511,17 € Po ashtu është bërë përmirësimi i të dhënave për zonat dhe kategoritë e caktuara tatimore në 150 raste. Është bërë përmirësimi në kompjuter i adresave (rrugëve) në 340 raste. Është bërë përmirësimi i gabimeve eventuale teknike në faturat e tatimit mbi pronën në 280 raste. Është bërë kontrollimi i gjendjes të borxhit të tatimit në pronë për lëshimin e vërtetimeve tatimore për 8771 raste. Janë lëshuar 8,210 vërtetime mbi tatimin në pronë.

Është bërë matja dhe regjistrimi i objekteve të paregjistruara gjatë vitit paraprak në 2200 raste. Janë reregjistruar objekte banesore, afariste, industriale dhe garazha gjithsej 320 objekte. Është bërë kontrollimi i objekteve në teren në bazë të ankesave të tatimpaguesve në 661 raste. Janë përgatitur dhe sistemuar për shpërndarje 22,300 vërejtje të fundit për mos pagimin e tatimit në pronë. Janë shpërndarë 34,200 letër-kujtesa për tatimin në pronë. Bordi i ankesave ka pranuar 1,077 ankesave nga tatimpaguesit. Prej tyre janë aprovuar 764 ankesa dhe janë refuzuar 313. Shërbimi i transakcionit të pronës, gjatë vitit 2009 ka pranuar 3679 lëndë, ku të gjitha lëndët janë kryer në afatin e duhur, prej tyre janë realizuar 3594 lëndë të tjerat janë në procedurë.

d. Sektori i ekonomisë

Kjo periudhë kohore ka rezultuar me kryerjen e 6,158 lëndëve, krahasuar me 3,375 sa ka pasur në vitin 2008. Të hyrat nga biznesi për vitin 2009 kanë qenë 590,280.00€ që është për 10% më shumë se në vitin paraprak me gjithë zbritjen e taksave për biznese që është bërë në fillim të vitit. Në mos përmbushjen në tërësi të këtij zëri buxhetor ka ndikuar mos përgjegjshmëria e obliguesve, numri i vogël i inspektorëve të tregut, mos përputhshmëria e adresave të biznesit si dhe lëshimet e tjera administrative dhe procedurale gjatë fazës së regjistrimit të shoqërive tregtare në MTI. Drejtoria ka bërë planin operativ që i gjithë personeli që merren me lëshimin e lejeve të punës të dalin në terren për dhënien e sugjerimeve dhe këshillimeve që të gjitha bizneset që operojnë në territorin e komunës së Prishtinës të pajisen me leje pune.

Në sektorin e transportit të udhëtarëve me auto-taksi janë bërë ndryshime cilësore dhe vizuale duke zbatuar Rregulloren mbi këtë lloj transporti ku qytetarëve u është ofruar siguri si dhe transparencë lidhur me shfrytëzimin e këtij lloj shërbimi, me vendosjen e shenjave identifikuese mbi auto-veturat. Gjatë periudhës raportuese është realizuar projekti i pestë me radhë investiv për komunitetin e biznesit. Sektori i ekonomisë në bashkëpunim me KFOR-in Finlandez kanë realizuar projektin e përbashkët në vlerë prej 70,000.00 € Nga ky projekt kane përfituar 13 biznese, projekti ka pas për qëllim mbështetjen e bizneseve të vogla me makina, vegla pune dhe pajisje tjera për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Në vazhden e projekteve për zvogëlimin e papunësisë, është realizuar projektin “Trajnimi i të rinjve të pa punë në ndërmarrësi” ku për 36 ditë pune janë aftësuar 60 rinj për të filluar biznesin vetanak.

e. Sektori i inspeksionit

Inspektorët e tregut dhe bujqësisë kanë qenë të angazhuar në kryerjen e punëve dhe detyrave sipas planit vjetor të punës, në kontrollimin e subjekteve afariste lidhur me regjistrimin e tyre në Zyrën për Regjistrim të Bizneseve në MTI, pajisjen e tyre me leje të punës dhe vazhdimin të tyre të cilave u ka skaduar afati. Në këtë drejtim janë dhënë 894 urdhëresa me shkrim me afat ligjor deri sa pronaret e bizneseve të pajisen me leje të punës dhe të bëjnë vazhdimin e tyre të cilave u ka skaduar afati dhe të bëjnë pagesën e taksës vjetore sipas Ligjit mbi tregtinë e brendshme. Po ashtu për mos posedim dhe mos pajisje me leje në afatin ligjor janë mbyllur dy lokale (auto tregu arena dhe një shitore).

Për mos respektim të fillimit dhe mbarimit të orarit të punës nga lëmi i tregtisë, hotelerisë, zejtarisë dhe shërbimeve, në territorin e komunës së Prishtinës janë ushtruar 15 fletë paraqitje gjykatës për kundërvajtje. Është punuar në kontrollimin dhe largimin e shitësve ambulant nëpër rrugët e qytetit, trotuare, sheshe publike dhe futja e tyre nëpër tregje të organizuara. Kontrollimi është bërë në bashkëpunim me inspektorët komunal dhe sanitar dhe Policinë e Kosovës. Në këtë drejtim janë bërë 2088 intervenime dhe largime të tyre. Është konfiskuar një sasi e konsiderueshme e mallrave ushqimore dhe jo ushqimore në vlerë prej 7,526 €

Pasqyra 5: Aktivitetet e inspeksionit të tregut

Gjithsej Kontrollime	Procesverbale	Fletëparaqitje për kundërvajtjes			Masat administrative		Sasia e mallit të asgjësuar		Urdhëresa me shkrim	Nr. Objekteve të mbyllura	Largim nga Rruga.	Ankesa të qytetarëve	Konfiskim	
		Penale	Delikt ekonomik	Kundërvajtje	Aktivendime	Pëlqimet ,kushtet minimale teknike.	Në litra	Në kilogram					Përkohësisht	Pa kthim
7350	3776	-	-	75	120	747	13477	32994	894	23	2088	10	-	7.526 €
Mjetet e realizuara nga pëlqimet					Vlera e mallit të asgjësuar				Vlera e mallit të hedhur jashtë shitjes-qarkullimit					
102,669,03.-€					69.044 €				439.270,00.-€					

Në kontrollimin e mallrave në shitje me pakicë dhe shumicë, me afat të skaduar, prishura, dëmtuara dhe të meta tjera janë nxjerrë jashtë qarkullimit mallra në vlerë prej mbi 439,270 € Inspektimet janë bërë në bashkëveprim me inspektorët e autoritetit tatimor të Kosovës. Kontrollimi është bërë konform dispozitave të Ligjit mbi tregtinë e brendshme dhe Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit. Sipas kërkesës së Policisë së Kosovës, është bërë kontrollimi i objekteve hoteliere dhe tjerave të cilat veprimtarinë e vet e ushtrojnë gjatë orëve të natës. Për mos posedim të lejes së punë dhe mos respektimit të saj përkohësisht janë mbyllur 23 lokale deri sa janë pajisur me leje apo eliminuar të metat e konstatuara.

Sipas kërkesave të pronarëve të bizneseve është bërë inspektimi i 747 lokaleve lidhur me plotësimin e kushteve minimale teknike dhe se pas konstatimit komisionit për pranimin e lokale se të njëjtat i plotësojnë kushtet minimale teknike, sanitare higjienike dhe kushtet tjera sipas rregullores e cila e trajton këtë lëmi janë lëshuar 662 procesverbale dhe janë drejtuar për tu pajisur me leje të punës. Janë inkasuar mjeje prej 102.669 € Lidhur me kontrollimin e mallrave me prejardhje bimore, janë marrë 77 vendim për asgjësim të mallrave në vlerë prej 69,044€ Janë proceduar 14 fletë-paraqitje për kundërvajtje gjykatës kompetente.

f. Sektori për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural

Në Sektorin e Bujqësisë janë përcjell punët dhe aktivitetet në lëmin e bujqësisë si: procesi i mbjelljeve pranverore, përgatitja dhe organizimi i korrje-shirjeve, këshillime profesionale të fermerëve, procesi i mbjelljeve vjeshtore, vlerësimin e gjendjes si dhe dëmet e shkaktuara në bujqësi. Janë realizuar dhe aktivitetet projekte të ndryshme në vlerë prej 217,498 € siç paraqitet në vijim:

○ Realizimi i mbjelljeve pranverore	---
○ Furnizimi me farë misri dhe plehra minerale	20.245,00
▪ Furnizimi me plehra minerale për kultivimin e kulturave bujqësore – patateve	9.200,00
▪ Furnizimi me serra	13.510,00
○ Meliorimi i livadheve dhe kullosave	49.500,00
○ Përgatitja dhe organizimi i procesit të korrje-shirjes	---
○ Këshillime profesionale të fermerëve	---
○ Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga breshëri dhe vërshimet	---
○ Veterina mobile fushore	23.600,00
○ Furnizimi me artikuj për përkrahje të fermerëve në blegtori	9.480,00
○ Subvencionimi i gjedheve qumështore	49.967,00
○ Eliminimi i qenve endacak	14.546,00
○ Realizimi i mbjelljeve vjeshtore	---
○ Furnizimi me farë gruri dhe plehra minerale	27.450,00
Gjithsej:	217.498,00

Bazuar në programin e të mbjellave pranverore për vitin 2009 në Komunën e Prishtinës janë mbjellë gjithsej 1.770 ha me kultura pranverore. Sipërfaqet e mbjella me kultura pranverore/ha: tërshërë 118 ha, misër 1 070 ha, bimë foragjere 195 ha, patate 328 ha, perime 28 ha, fasule si monokulturë 18 ha, elb pranveror 13 ha. Me qëllim të përkrahjes së fermerëve për mbjellje pranverore si dhe stimulimin e fermerëve për rritjen e sipërfaqeve me kultura pranverore Komuna e Prishtinës ka bërë subvencionimin e disa kategorive të fermerëve me disa projekte si:

- **Furnizimi me farë misri dhe plehra minerale:** Me projekt kanë përfituar 243 fermer nga 10 kg farë misri dhe 150 kg pleh mineral (për mbjelljen e 0.5 ha me misër). Kriter në përzgjedhjen e tyre ka qenë gjendje e rëndë sociale dhe që e mbjellin misrin dhe përzgjedhja e tyre është bërë nga ana e bashkësive lokale. Vlera e projektit sipas kontratës është: 20.245,00 € dhe projekti është realizuar në muajin maj.
- **Furnizimi me pleh mineral për kultivimin e kulturave bujqësore:** janë përkrahur gjithsej 50 fermer me nga 400 kg pleh mineral. Kriter i përzgjedhjes: fermerët që mbjellin mbi 1 ha patate dhe përzgjedhja e tyre është bërë nga ana e bashkësive lokale. Projekti është realizuar në muajin maj.
- **Furnizimi me serra:** Me projekt është paraparë përkrahja e 100 fermerëve me serra në sipërfaqe prej 54 m². Kriter i përzgjedhjes: fermerët që merren me perimtar. Përzgjedhja e tyre është bërë nga ana e bashkësive lokale. Projekti është realizuar në muajin maj.
- **Meliorimi i livadheve dhe kullosave:** Ky projekt përfshinë regjionin e Gollakut i cili karakterizohet me sipërfaqe të mëdha të livadheve dhe kullosave në një sipërfaqeje

prej 100 ha të livadheve dhe kullosave, apo sipërfaqeve të tokës bujqësore të mbetur djerrinë për vite të tëra. Përfitues nga ky projekt janë fermerët të cilët kanë sipërfaqe të livadheve, kullosave apo edhe arave të mbetura djerrinë për vite të tëra (4-5 vite). Meliorimi i livadheve dhe kullosave përfshinë një sipërfaqe prej 0.5-1.00 ha, për një fermerë – përfitues nga ky projekt. Përzgjedhja e fermerëve është bërë në bashkëpunim me përfaqësuesit e komunitetit.

Përgatitja dhe organizimi i procesit të korrje-shirjes: Gjatë muajit qershor është organizuar takim me pronarët e auto-kombajnave, të cilët janë informuar rreth çmimit të korrje-shirjes, subvencioneve në derivate të naftës etj. dhe njëzëri është konstatuar se për të pas një fushatë të suksesshme duhet një angazhim i përbashkët i të gjitha strukturave të përfshira në këtë proces. Procesi i korrje-shirjeve ka filluar me datë: 08/07/2009 dhe kanë përfunduar me datë 20/08/2009. Në procesin e korrje-shirjeve kanë marrë pjesë 19 kombajna. Çmimi i korrjes sillej prej 90€ha duke u bazuar në faktin se M.B.P.ZH.R. ka bërë subvencionimin në derivate të naftës për auto-kombajner, prandaj edhe është arritur marrëveshja në mes M.B.P.ZH.R-s, Komunave dhe auto-kombajnerëve që të respektohet çmimi i lartpërmendur. Rendimentet e grurit ishin mesatare 3,500 kg/ha). Faktorët që kanë ndikuar në uljen e rendimenteve në raport me vitin e kaluar (4 500kg/ha) janë kushtet atmosferike- të reshurat që kanë mbretëruar para dhe gjatë fushatës së korrje-shirjes. Kombajnat e kyçura në procesin e korrje-shirjeve ishin të përgatitura mirë teknikisht dhe të pajisura me aparatën për fikjen e zjarrit, prandaj edhe humbjet gjatë korrjes kanë qenë në kufijtë e lejuar (3%). Në përgjithësi punët gjatë fushatës së korrje-shirjeve kanë shkuar sipas plan programit të paraparë dhe si rrjedhojë e kësaj nuk ka pas ankesa as nga ana e fermerëve dhe as nga ana e kombajnerëve.

Këshillime profesionale të fermerëve: Në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural është realizuar projekti “ Dhënia e këshillave fermerëve “ me që rast u janë dhënë këshilla fermerëve të tri kategorive: fermerëve ekzistencial, fermerëve gjysmë komercial dhe fermerëve komercial.

Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga breshëri dhe vërshimet: Pasi në disa lokalitete të komunës së Prishtinës (Keqekollë, Prapashticë dhe Marevc) janë dëmtuar kulturat bujqësore nga breshëri, menjëherë është formuar komisionin për të bërë vlerësimin e dëmeve. Komisioni ka konstatuar se dëmet e shkaktuara nga breshëri në kulturat bujqësore janë të konsiderueshme dhe se lokaliteti më i prekur është lagjja Pacolli dhe Gërbeshi, ku janë dëmtuar mbi 95% të kulturave bujqësore.

Veterina mobile fushore: Ruajtja, sigurimi shëndetësor, fisnikërimi dhe shtimi i fondit blegtoral është një ndër prioritetet e Sektorit të bujqësisë, përveç kësaj edhe vaksinimi i qenve është një ndër prioritetet si preventivë ndaj përhapjes së sëmundjeve të ndryshme ngjitëse. Implementimi i këtij projekti ka filluar në muajin Maj, me që rast është bërë vaksinimi i 3 882 krerë gjedheve dhe vaksinimi i 1540 qenve, si dhe mbarësimi artificial i 800 krerë gjedheve (lopëve).

Furnizimi me artikuj për përkrahje të fermerëve në blegtori: Komuna në bashkëpunim me Shoqatën “Heifer Intrenacional Kosova”, e cila ka përkrah 20 fermerë me gjendje të rëndë sociale me nga një mështjerrë mbarse të racës “Hollstejn”, ka realizuar projektin duke siguruar ushqimin e koncentruar (11.000 kg), vitamina dhe minerale (470 kg), enët për mjelje (20 copë), transportin e gjedheve si dhe sigurimin e masave profilaktike (karantinën).

Subvencionimi i gjedheve qumështore: Me qëllim të përkrahjes së fermerëve në lëmin e blegtorisë, Komuna e Prishtinës ka bërë subvencionimin e fermerëve gjysmë komercial dhe komercial që kanë gjedhe qumështore. Aplikuesit është dashur të plotësojnë kriteret e mëposhtme: të kenë së paku 4 krerë gjedhe qumështore, matrikulimi i gjedheve, të kenë stallë, të jenë banor të Komunës së Prishtinës dhe të mos kenë obligime tatimore. Kanë aplikuar 169 fermer me gjithsej 1456 krerë gjedhe qumështore. Gjatë verifikimit është konstatuar se kriteret i plotësojnë 162 fermer me gjithsej 1243 krerë gjedhe qumështore dhe në bazë të kësaj çdo fermerë për krerë do të përfitoj nga 40.20 €

Eliminimi i qenve endacak: Eliminimi i qenve endacak është realizuar gjatë muajve Mars, Prill, Maj dhe Qershor. Gjatë këtij aksioni janë eliminuar gjithsej 1.039 qen endacak, është përfshirë tërë qyteti dhe zonat rurale, ky aksion ka rezultuar të jetë i suksesshëm. Realizimin e këtij operacioni e ka bërë N.P.K. "Hortikultura" me asistimin e Policisë së Kosovës.

Realizimi i mbjelljeve vjeshtore: Sa u përket mbjelljeve vjeshtore 2009-2010 janë mbjell me grurë 1,940 ha dhe me bimë foragjere 45 ha.

Furnizimi me farë gruri dhe plehra minerale: Me qëllim të përkrahjes së familjeve që konsiderohen si raste sociale dhe të cilat njëkohësisht janë të interesuara për mbjelljen dhe kultivimin e drithërave, si edhe fermerët që kanë pësuar dëme nga fatkeqësitë natyrore, Komuna ka përkrahur 300 familje me farë gruri dhe plehra minerale (me 150 kg farë gruri dhe 150 kg pleh mineral) dhe si rezultat i kësaj përkrahjeje janë mbjell me grurë 150 ha më shumë se sa që ishin planifikuar.

Gjatë vitit 2009, sektori i ekonomisë ka pranuar 18,853 lëndë, prej të cilave të përcjellura në vitin 2010 janë 421 lëndë.

6. DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

a. Sektori i Urbanizmit

Ky sektor ka punuar në përgatitjen, koordinimin dhe qasjen në hartimin e planeve rregulluese, të përcaktuara me detyrat programore për periudhën raportuese, përgatitjen e detyrave programore, përgatitjen e materialit tenderues për planet rregulluese, përgatitjen e metodologjisë së mbajtjes së punëtorive, përgatitjen dhe mbajtjen e ekspozitave si dhe përgatitjen dhe mbajtjen e diskutimeve publike për planet përkatëse rregulluese. Në bazë të këtyre detyrave programore prioritet i është dhënë hartimit të planeve rregulluese për Lagja Muhaxhirëve, Zona Ekonomike, Qyteza Pejton, Vellusha, dhe Çamëria. Këto plane rregulluese janë në procedurë të miratimit. Gjatë periudhës raportuese është miratuar plani rregullues për lagjen Dardania. Në këtë periudhë kohe ka filluar edhe plotësimi dhe ndryshimi i planit rregullues Mati I. Lidhur me këto plane janë mbajtur një numër i konsiderueshëm i punëtorive me kompanitë të cilat janë duke i hartuar projektet. Duke respektuar dispozitat ligjore janë organizuar edhe takime me qytetarë si konsultime urbane dhe diskutime publike. Gjithashtu për shumë lagje janë mbajtur edhe shumë takime konsultative lidhur me projektet urbo-arkitektonik.

Përmes këtij shërbimit janë përcaktuar lokacionet për objektet me karakter shoqëror në harmoni me planin strategjik zhvillimor. Janë përgatitur materialet me propozimet grafike, në bazë të të cilave janë hartuar propozim vendimet me arsyetimet përkatëse. Këto vendime kanë kaluar të gjitha organet e kuvendit për shqyrtim. Për lokacionet e caktuara për

ndërtimin e objekteve për të cilat ka qenë investitor komuna, është përgatitur i tërë dokumentacioni tekniko investiv, detyrat dhe programet projektuese për hapjen e tenderëve, është marrë pjesë në komisionet për vlerësimin e dokumentacionit të ofertave, si dhe është bërë menaxhimi i realizimit - ndërtimit të këtyre objekteve nga personeli civil profesional i kësaj drejtorie.

Gjatë periudhës raportuese, në sektorin e Urbanizmit kanë arritur 1570 kërkesa me karakter të ndryshëm, ndërsa të bartura nga viti paraprak kanë qenë 188. Numri i kërkesave në krahasim me vitin paraprak ka pas një rënie prej 35.66%. Numri i lejeve urbanistike në vitin 2009 është për 23 leje më i ulët se në vitin 2008 për shkak të rënies së kërkesës për leje urbanistike. Përmbajtja e kërkesave ka qenë kryesisht caktimi i lokacioneve, kushtet e lokacioni, caktimin e kushteve urbanistike-teknike, lejeve ndërtimore, lejeve paraprake, leje për rrënimin e objekteve, leje përdorimi të objekteve, informacione për destinimin e sipërfaqeve nga planet përkatëse rregulluese. Konkluzione për miratimin e projekteve urbo-arkitektonike dhe atyre ideore për zona përkatëse, shqyrtimin e ankesave të qytetarëve të natyrave të ndryshme.

Pasqyra 6: Kërkesat dhe procedimi i tyre nga sektori i Urbanizmit

Nr.	Përshkrimi	2009	2008
1.	Numri i Lejeve Urbanistike	194	217
2.	Numri i Lejeve të Ndërtimit	65	92
3.	Refuzime	199	447
4.	Informime	513	705
5.	Njoftime	121	121
6.	Të miratuara	282	354
7.	Përgjigje	33	0
8.	Konkluzë	08	0
10.	Numri i lejeve të përdorimit	02	06
11.	Në procedurë	153	188
	Gjithsej	1570	2130

Gjatë periudhës raportuese, zyrtarët e kësaj Drejtorie kanë marrë pjesë në hapjen dhe vlerësimin e tenderëve të organizuar nga zyra e prokurimit të komunës si dhe në pranimin teknik të objekteve dhe të punëve të kryera. Është punuar në hartimi i programeve për infrastrukturë teknike dhe sociale. (projekti i unazës së brendshme, pjesa perëndimore e “Unazës Qendër”, në lagjet me planet rregulluese ka filluar projektimi i infrastrukturës primare të rrugëve. Gjatë kësaj periudhe raportuese ka filluar mbikëqyrje në objektet shkollore. Të hyrat nga lëshimi i lejeve të ndërtimit për periudhën janar-dhjetor 2009 kanë qenë 8.756.842 € që është për 14.98 % më shumë se në vitin 2008 (kur janë realizuar 7,615,488 €).

Në bazë të detyrave projektuese janë në fazën e tenderimit këto plane urbane: Plani Zhvillimor Komunal, Plani Zhvillimor Urban, Prishtina e Re (me tri zona: Zona perëndimore, Zona qendrore dhe Zona lindore), është hartuar detyra projektuese për Zonën Historike, detyra projektuese dhe lokacioni për objektin administrativ në lagjen e Muhaxhirëve, detyra projektuese për sheshin Zahir Pajaziti, Adem Jashari dhe sheshi i Pavarësisë (janë tenderuar dhe vlerësuar dhe nuk kanë kaluar fazën e miratimit).

Janë caktuar lokacionet për Tregun e veturave, Panairin e Kosovës, Institutin e ndërtimit në Bërnice të ulët, laboratorin e Kimisë, lokacioni për shkollën e muzikës, lokacioni për shkollën fillore në Hajvali, caktimi i lokacioneve për kioske informative dhe janë hulumtuar lokacionet për objektin e Doganës dhe ATK-së, lokacioni për çerdhe në lagjen „Kodra e trimave” dhe në lagjen Çamëria. Janë miratuar projekte urbane-arkitektonike dhe projekte ideore për zona të caktuara në mungesë të planeve rregulluese. Është miratuar projekti urbanistik sipas kushteve të lokacionit për Sh.P.K „Marigona Rezidence”, projekti urbanistik sipas kushteve të lokacionit për „Nic Holding” Sh.P.K. si dhe për disa lokacione më të ngushta.

Në pajtim me programin e punës për periudhën raportuese janë kryer edhe këto aktivitete:

- Planifikimi/porositja e projektimit të projekteve të infrastrukturës;
- Mbikëqyrja e objekteve për të cilat investues është Kuvendi Komunal;
- Marrja pjesë në pranimet teknike të objekteve dhe punimeve të kryera;
- Marrja pjesë në komisionet për vlerësimin e tenderëve;
- Përgjigjja e lëndëve që kanë të bëjnë me infrastrukturë dhe rindërtim;
- Marrja pjesë komisionet-ekipet e eksperteve të caktuar nga bordi i drejtorëve;
- Përgatitja e vendimeve për komisione për pranim teknik dhe leje të përdorimit;
- Kontrollimi i projekteve që dorëzohen për leje të ndërtimit (pjesa e stabilitetit dhe instalimeve)

Është vizituar-incizuar gjendja faktike e rrugëve të caktuara si prioritet nga Kuvendi Komunal. Janë përgatitur detyrat projektuese dhe janë përcjellë punimi i projekteve për rrugët:

- Ruga unazore “ Unaza e brendshme” pjesa perëndimore dhe lindore
- Rruga “B “ (Mati I) së bashku me rrugët lidhëse
- Rrugët që lidhë rrugën “Tirana “ me rrugën “Ahmet Krasniqi”
- Rruga “Tahir Zajmi”
- Rruga “Enver Maloku”,
- Rruga pjesa e pare e Aeroportit dhe rruga paralele Prishtinë- Shkup (Kalabria)
- Rruga Koliq – Lagjeja Podaj
- Rruga në fshatin Prugovc
- Rruga Thanishtë (Slivove)-Llajshevc
- Rruga Siqueve – Sharban
- Rruga Bardhosh – Arbnesh
- Rruga Vranidoll – lagja Serovc
- Rruga Rimanisht –Siqevë
- Rruga Hasan Remniku (vazhdimi deri te fshati Llukar)
- Rruga Hilmi Rakovica
- Rruga Ibrahim Fehmiu
- Rruga Vlora
- Rruga Stallove-Cervdeik-Viti e Marevcit
- Rruga Bill Klinton (zgjerimi i rrugës)
- Nënkalimi në rrugën Bill Klinton te KEK-u

Është bërë mbikëqyrja e disa objekteve për të cilat investues ishte Komuna e Prishtinës si dhe është punuar në paramasa dhe paralogari për shumë projekte si në vijim:

- Mbikëqyrja e ndërtimit të objektit të Komunës së re
- Mbikëqyrja e ndërtimit të aneksit objektit të shkollës fillore “Ismail Qemajli”,
- Mbikëqyrja e ndërtimit të aneksit objektit të shkollës fillore “Zenel Hajdini”,
- Mbikëqyrja e ndërtimit të aneksit objektit të shkollës fillore “Nazim Gafurri”,

- Mbikëqyrja e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në lagjen Podaj të fshatit Koliq,
- Mbikëqyrja e ndërtimit të objektit të aneksit të shkollës fillore në Suteskë,
- Mbikëqyrja e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në fshatin Siqevë,
- Mbikëqyrja e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në fshatin Rimanishtë,
- Mbikëqyrja e ndërtimit të objektit të shkollës së gjelbër
- Mbikëqyrja e ndërtimit të objektit të shkollës së mesme “Xhevdet Doda”
- Mbikëqyrja e ndërtimit të objektit të sallës së edukatës fizike për shkollën “Meto Bajraktari”
- Mbikëqyrja e ndërtimit të objektit të sallës së edukatës fizike për shkollën “Ali Sokoli”
- Mbikëqyrja e ndërtimit të objektit të sallës së edukatës fizike për shkollën “Xhemail Muatafa”
- Mbikëqyrja e ndërtimit të objektit të sallës së edukatës fizike për shkollën “Hilmi Rakovica”
- Mbikëqyrja e ndërtimit të objektit të sallës së edukatës fizike për shkollën “Mitrush Kurteli”
- Mbikëqyrja e punimeve në objektin e trashëgimisë kulturore “Hamami i Madh”,
- Koordinimi i punëve dhe kontaktet me institutet për mbrojtjen e monumenteve,
- Mbikëqyrja- bashkë menaxhimi i koncesionit për fshatin ndërkombëtar,
- Mbikëqyrja e objektit për banim social,
- Mbikëqyrja e mbulimit të lumit “Prishtina”
- Mbikëqyrja e punimeve në Fasadimin e Objekteve të Bulevardit Nëna Terese (Faza II), Bulevardit “Dëshmorët e Kombit” dhe rrugës “Galibardi”
- Kanalizimi në objektin e Komunës,
- Rregullimi i ujësjellësit në lagjen Kolovicë,
- Rregullimi i kanalizimit fekale në fshatin Vranidoll,
- Rregullimi i kanalizimit fekale në fshatin Lebanë,
- Ndërtimi i rrugës “Sheshi i Arbërit”,
- Ndërtimi i kanalizimit atmosferik përgjat rrugës “Isa Kastrati “,
- Ndërtimi i QMF në lagjen Vreshta,
- Ndërtimi i QMF në lagjen Velani,
- Ndërtimi i QMF në fshatin Hajvali,
- Ndërtimi i QMF në fshatin Arbëri
- Mbikëqyrja e ndërtimit të objektit ambulancës në Sharban
- Renovimi i ambulancave në fshatrat Koliq, Keqekollë, Barilevë
- Ndërtimi i terreneve sportive në lagjen “Kodra e Diellit”
- Ndërtimi i terreneve sportive në lagjen “Arbëri ”
- Ndërtimi i terreneve sportive në shkollën fillore “Zenel Hajdini”
- Ndërtimi i terreneve sportive në shkollën fillore të fshatit Keqekollë.
- Ndërtimi i terreneve sportive në fshatin Grashticë
- Ndërtimi i terreneve sportive në fshatin Busi
- Ndërtimi i terenit sportiv Llukar,
- Ndërtimi i rrugës “Xhevat Begolli”, “Mihajl Grameno” dhe kanalizimi në Lugëmir
- Renovimi i kulmeve te disa shkollave pjesa e I dhe II,
- Ndririmi mi dritareve dhe dyerve në IP “Gëzimi Ynë”, “Yllkat”, shkolla fillore “Daerdania”, “Asim Vokshi” Meto bajraktari” dhe Shkolla “Alaudin”
- Gëlqerosja e disa shkollave të Komunës së Prishtinës pjesa I dhe II,
- Renovimi i nyjeve sanitare në disa shkolla te Komunës së Prishtinës.

b. Sektori i Kadastrit dhe Gjeodezisë

Sektori për Kadastër dhe Gjeodezi gjatë periudhës raportuese është angazhuar rreth kërkesave të personave juridik siç janë: Kuvendi Komunal dhe organet e administratës, organet e pushtetit qendror dhe Agjensionit Kosovar të Privatizimit për përgaditjen e

dokumentacionit për privatizim. Ky organ për nevojat e Komunës së Prishtinës ka punuar të gjitha kërkesat që janë me prioritet të veçantë në interes të përgjithshëm për Komunën dhe atë sidomos për nevojat e infrastrukturës, planifikimit dhe shërbimit pronësor. Lëndë të terrenit janë pranuar gjithsej 916, prej të cilave janë kryer të gjitha me përjashtim të 2 lëndëve që janë ende në procedurë.

Në bazë të dokumentacionit juridik dhe teknik për nevojat e ndërrimeve në operatin kadastral janë pranuar 2915 lëndë, prej të cilave 2897 janë kryer dhe të tjerat janë në procedurë ose janë refuzuar. Janë pranuar 1176 lëndë të intabulimit – hipotekave: 806 për regjistrim dhe 370 për çregjistrim. Zyra për certifikata, fletë posedim dhe kopje plani ka pranuar dhe aprovuar 16,245 aplikacione: 8554 fletë podesime, 7,595 kopje plani dhe 96 certifikata. Certifikata të ndihmës sociale dhe vërtetime për aplikim për viza janë pranuar 12,500. Ndërsa letra të tjera si kërkesa nga gjykatat dhe institucionet tjera janë pranuar 550. Në total, gjate vitit 2009 janë pranuar 37,542 kërkesa. Gjatë këtij viti kalendarik sektori i kadastrit ka krijuar të hyra buxhetore (taksa) në vlerë prej 429,330.00€

c. Sektori i Inspeksionit të Ndërtimit

Sektori i inspeksionit të ndërtimit, gjatë periudhës raportuese, punët dhe detyrat i ka kryer në pajtim me dispozitat ligjore: Ligjit për Ndërtim, Udhëzimeve Administrative dhe akteve tjera që e rregullojnë punën e këtij sektori. Me riorganizimi e organeve të administratës, Sektori i Inspeksionit të Ndërtimit që nga fillimi i këtij viti, vepron në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Gjatë vitit raportues, e kryesisht në periudhën e parë të vitit, sektori ka hasë në vështirësi në kryerjen e punëve nga shkak i numrit të pakt të inspektorëve të ndërtimit, mos angazhimi i mjaftueshëm në përmbushjen e detyrave nga disa prej tyre, gjë që rezulton me mos vazhdimin e kontratave të punës për 3 zyrtar.

Gjatë kësaj periudhe, kompania private "Parc- Projekt" ka ndihmuar inspeksionin në evidentimin dhe përcjelljen e gjendjes në teren. Me angazhimin maksimal të këtij sektori është bërë ndërprerja dhe futja nën kontroll të ndërtimeve. Ndërtimet pa leje kanë qenë më të shprehura në zonat të cilat nuk kanë qenë të mbuluara me plane rregulluese (Prishtina e Re, Qagllavice, Bardhosh, Hajvali, Matiqan).

Sektori i inspeksionit ka shqyrtuar 730 lëndë të ndryshme, prej të cilave 32 kanë qenë të vitit paraprak, të cilat kanë të bëjnë me evidentimin e objekteve të filluara pa leje dhe objekte të tjera. Prej tyre, ky sektor ka evidentuar se 82 objekte që janë evidentuar kanë pasur leje ndërtimore. Janë lëshuar 583 aktvendime për ndërprerje të punëve. Janë rrethuar 3 objekte. Është lëshuar një urdhëresë. Janë nxjerrë 85 aktvendime për rrënim të objekteve, prej të cilave 75 janë rrënuar. Ky sektor ka pranuar 188 ankesa, kërkesa dhe intervenime nga qytetarët, prej të cilave 183 janë shqyrtuar.

d. Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit

Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit ka bërë 330 kontrollime, 6 kërkesa dhe njoftime në lidhje me mbrojtjen e ambientit (ujit dhe ajrit) siç janë: kontrollimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, trotualet, ujërat e zeza, si dhe zhurmat e shkaktuara nëpër lokale afariste si dhe nga gjeneratorët. Sektori përballet me mungesë të stafit.

Gjatë vitit 2009, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka pranuar 7,395 lëndë përmes zyrës pritëse dhe 32,453 lëndë përmes librit të evidencës, gjithsej 39,848 lëndë të ndara nëpër sektorë si në tabelën më poshtë.

Pasqyra 7: Lëndët e pranuar në Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit gjatë vitit 2009

	Urbanizmi	Kadastrit	Inspeksioni	M.Mjedisit	Gjithsej
Lëndë përmes zyrës pritëse	1570	5580	239	6	7395
Lindë sipas librit të evidencës	0	31962	491	0	32453
	1570	37542	730	6	39848

7. DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCËS CIVILE

a. Shërbimi i Transportit

Puna e Shërbimit të Transportit gjatë kësaj periudhe, ka qenë kryesisht e përqendruar në aktivitetet rreth transportit publik, sinjalizimit në përgjithësi, parkingjeve, transportit-konfiskimit me merimangë, semaforëve, bashkëpunimit me Organizatën Gtz për menaxhimin e mbeturinave dhe riciklimin e tyre. Në kuadër të angazhimit të avancimit të transportit, është përcjell në vazhdimësi mbarëvajtja e transportit publik në territorin e Komunës së Prishtinës. Po ashtu është bërë vazhdimi i orareve për operimin e transportit publik për linjat urbane si dhe linjat për Fushë Kosovë dhe fshatrat e Fushë Kosovës. Është bërë menaxhimi i shërbimit merimangë dhe parkingut në Zonën industriale ku vendosen automjetet e konfiskuara nga policia gjatë tërë vitit. Janë dhënë në shfrytëzim (të rezervuara) vendparkime për institucione shtetërore të vendit dhe të huaja pa pagesë, si dhe për subjekte fitimprurëse me pagesë. Janë dhënë me koncesion parkingjet publike në shiritin e ndarë rrugor.

Janë bërë rregullime të shenjave ekzistuese të dëmtuara nëpër rrugë të qytetit dhe vendosje të shenjave të reja në disa rrugë. Punët e sinjalizimit janë në vazhdim e sipër në vlerë prej 76.405,00€ Është bashkëpunuar vazhdimisht me Drejtorinë e Trafikut dhe Njësinë Regjionale të Trafikut të Policisë së Kosovë për përmirësimin e trafikut. Nga Shërbimi i “Merimangës” janë inkasuar 182.202,32 € nga parkingjet e rezervuara 66.900,00 € nga parkingjet me koncesion prapa “Pallatit të Rinisë”vetëm për katër muaj gjatë vitit 2009 janë inkasuar 88.880,00 € nga parkingjet publike me koncesion “Park Projekt-ltg” 86.000,00 €

Gjatë vitit 2009 kanë pranuar 342 lëndë dhe janë të kryera si në vijim: 216 lëndë janë përfunduar me njoftime, 81 janë kryer me aktvendime, 41 me pëlqime dhe 4 janë bartur në sektorë të tjerë. Nga këto lende janë inkasuar 388.457,78 €

b. Shërbimi i Energjetikës

Gjatë vitit 2008 shërbimi energjetikë ka punuar kryesisht këto punë: mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjen e semaforëve, vërtetimin e faturave për shpenzimin e energjisë elektrike të ndriçimit publik dhe të semaforëve, përpilimin e ofertave në bazë të projekteve të ndriçimit publik, semaforave, për ofertim, inkasimi i të hyrave bugetore për leje ndërtimi të shtrirjes së kablllove dhe kanalizimit kabllorik, dhënja e detyrave projektuese për projektimin e rrugëve të reja – për pjesën elektrike, mbikëqyrja e pjesës elektrike të

rrjetit 0.4 kV, ndriçimit publik dhe kanalizimit kablovik të rrugëve të reja që janë ndërtuar dhe që janë në ndërtim e sipër gjatë vitit 2009.

Për mirëmbajtjen dhe sanimin e ndriçimit publik për vitin 2009 kanë qenë të siguruara mjetet nga Bugjeti i Komunës së Prishtinës në shumë prej 390.000,00 € Në bazë të kontratës nr. 616 09 018 521 të dt. 15.04.2009, punët për mirëmbajtjen e ndriçimit publik i janë besuar N.P. “Monten” nga Prishtina në shumë 114,635.00 € ndërsa shuma tjetër rreth 286,000.00 € për sanim nuk është shfrytëzuar. Gjatë vitit 2009 janë mirëmbajtur gjithsejtë 226 rrugë. Shuma e mjeteve të shpenzuara për mirëmbajtjen e ndriçimit publik ka qenë rreth 90,615.00 € kanë ngelur pa u realizuar mjetet në shumë rreth 24,020.00 € Për mirëmbajtjen e semaforave për vitin 2009 janë siguar mjetet në shumë prej 75,000.00 € Për shpenzimin e energjisë elektrike të ndriçimit publik dhe të semaforave, e që janë 114 grupe matëse të aktivizuar janë shpenzuar mjetet rreth: 253,373.35 € Gjatë vitit 2009, shërbimi energjetik ka përpiluar ofertat me paramasë dhe paralogarit rreth 36, për dislokimin e rrjetit 0.4 kV ndriçimit publik të ri në rrugët që janë ndërtuar ose janë në ndërtim.

Gjatë lëshimit të Aktvendimeve për ndërtimin e kanalizimit kablovik energjetik, telefonik, shtrirjes së kabllove optike etj. janë inkasuar taksat në shumë prej 33,278.60 € Gjatë vitit 2009 shërbimi energjetik ka hartuar 12 detyra projektuese për punimin e projekteve të reja të rrugëve në qytet, duke përfshirë edhe pjesën elektrike të dislokimit të rrjetit 0.4 kV, ndërtimit të kanalizimit kablovik energjetik dhe të ndriçimit publik të ri. Gjatë vitit 2009 ky shërbim ka bërë mbikëqyrjen e rregullt të rrugëve që janë ndërtuar dhe ato vetëm për pjesën elektrike, për dislokimin e rrjetit 0.4 kV, ndërtimin e kanalizimit kablovik energjetik, ndërtimin e ndriçimit publik dhe të objekteve të tjera si shkollore ashtu, qendrave të mjekësisë familjare dhe objektit të ri të Komunës së Prishtinës.

c. Shërbimi për mirëmbajtjen e Gjelbërimit

Janë mirëmbajtur sipërfaqe gjelbëruese prej 514.087 m² kurse mjetet e shpenzuara për mirëmbajtje janë 250.000,00 € Gjatë vitit 2009 në qytet është bërë rregullimi i sipërfaqeve të reja gjelbëruese edhe atë në këto lokacione: Parku në Dardani; Parku në Ulpianë (te Fontana); Parku në Kodrën e Diellit (përballë Qerdhës së Fëmijëve); Sipërfaqja te Banesat e Bardha; Rregullimi i sipërfaqes përgjatë rrugës “Fehmi Lladrovci”; Rregullimi i sipërfaqes përballë stacionit të Autobusëve; Rregullimi i oborrit në SH.M. “Sami Frashri”; Pyllëzimi i sipërfaqeve në Mat. Njëkohësisht gjatë kësaj periudhe në rr.”Agim Ramadani”, Sheshin “Nënë Tereza”, Parkun e Qytetit dhe te Varrezat e Dëshmorëve është bërë mbjellja e luleve sezonale si dhe mirëmbajtja e tyre. Këto punë janë realizuar nga N.P.K.”Hortikultura”.

Është bashkëpunuar ngushtë me GTZ-në për menaxhimin e mbeturinave dhe riciklimin e tyre, duke përfshirë edhe NP “Pastrimi”.

Nga numri i kërkesave prej 145 të parashtruara këtij Shërbimi janë zgjidhë si vijon: pëlqime-aktvendime 22, njoftime 106, situacione për pagesë 9, material ofertues prokurimit 1, refuzim 2, urbanizmit në kompetencë 3, konstatim 2. Shërbimi për hapësirat publike ka pranuar 342 lende dhe janë te kryera te gjitha si me poshtë: 216 lende janë përfunduar me njoftime, 81 janë kryer me aktvendime, 41 me pëlqime dhe 4 janë barte ne sektor tjetër. Nga këto lende janë inkasuar gjithsej 388.457,78 € Te hyrat e përgjithshme në sektorin e Shërbimeve Publike janë 845.718,38 €

d. Shërbimi për mirëmbajtjen e rrugëve dhe varrezave

Në mirëmbajtjen dimërore të rrugëve dhe trotuareve të qytetit të Prishtinës gjatë vitit 2008/2009 janë përfshirë 78 rrugë nga kompania Toifor (Loto I) me vlerë të kontratës prej 92.990.78 € dhe 88 rrugë nga kompania Pastrimi me vlerë të kontratës prej 86.992.99 €. Janë shpenzuar 50,260 € për furnizim dhe montim të grilave e kapakëve të pusetave dhe pastrimi i ujmbledhsave në qytet. Për mirëmbajtjen e verore të rrugëve dhe trotuareve është angazhuar kompania Toifor (Loto I) me 48 rrugë, vlerë të kontratës prej 207.805.61 € dhe kompania Pastrimi (Loto II) me 42 rrugë me vlerë të kontratës 154.667.27 €. Rrugët rurale janë mirëmbajtur edhe nga kompania Dardania dhe Toifor.

e. Sektori i Emergjencës Civile

Sektori i Emergjencës Civile aktivitetin e vet e ka zhvilluar përmes Brigadës së Zjarrfikësve të Prishtinës (BZP), Qendrës për Informim, Alarmim dhe Koordinim (QIAK-u) dhe zyrtareve të administratës. Trajnimet, ligjëratat dhe seminarët e planifikuar në këtë vit janë realizuar me sukses dhe kanë ndikuar pozitivisht në realizimin e objektivave tona. Është punuar Vlerësimi i Rrezikut për Territorin e Komunës së Prishtinës i cili është aprovuar në Kuvendin e Komunës, është hartuar plani i punës së Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim, Komitetit për Shërbime Publike janë koordinuar aktivitetet me subjektet gjegjëse nga lemia e Sigurisë Civile. Është përgatitur raporti për KKMSH lidhur me zbatimin e masave mbrojtëse kundër zjarrit gjatë fushatës së korrije shirjeve. Janë përgatitur materialet dhe raportet për KKMSH, Këshillin Komunal për siguri të bashkësive si dhe janë punuar rregulloret për veprim, plani i punës, dinamika si dhe janë organizuar takime të rregullta.

Një projekt që vlen të theksohet në këtë raport është organizimi i vizitave të shkollave fillore dhe të mesme (47 sosh) në territorin e Komunës së Prishtinës. Qëllimi i këtyre vizitave ka qenë verifikimi i organizimit të Mbrojtjes dhe Sigurisë në këto shkolla në raste të ndryshme emergjente dhe para përgatitjes për organizimin e ligjëratave me nxënësit e këtyre shkollave me program të posaçëm rreth aftësisimit të personelit dhe nxënësve në organizimin për Mbrojtje dhe Shpëtim në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, si shpëtimi nga shpërthimi i zjarrit, evakuimi i popullatës, dhënia e ndihmës së parë, strehimi i tyre në vende të sigurta etj. Këtë projekt të rëndësishëm me sukses e kanë realizuar bashkëpunëtorët për aftësim dhe ai për evidentim.

Qendra për Informim, Alarmim dhe Koordinim si rëndom organizon kujdestarin 24 orë pa ndërpre ku operatorët kujdestar të Qendrës marrin dhe japin informata të ndryshme nga qytetarët dhe organet komunale, në raste emergjente gjithëherë është mobile. Gjatë kësaj periudhe kohore kjo Qendër është pajis me tetë monitor të sistemit të kamerave. Ka mirëmbajtur radiolidhjet me BL. Ka bërë formatizimin e programit të sistemit të qasjes (hyrje dalje) ka bërë verifikimin e të gjitha mjeteve teknike verifikimin e radiolidhjeve, ka vendosur dy pika të sinjaleve të Alarmit Publik, tenderimin radio lidhjeve për BZP-ën, përgatitur raportet ditore, javore dhe mujore. Ka përgatitur 186 kartela identifikimi ka pranuar më shumë se 1970 raste lajmërimi (informimi) nga qytetarët dhe subjektet komunale. Kryen edhe detyra të tjera konform nevojës a kërkohet nga kjo Qendër dhe është e përgatitur profesionalisht për kryerjen e detyrave të ndryshme në kuadër të kompetencave që ka.

Një punë voluminoze dhe të suksesshme në këtë vit e kanë realizuar Inspektorët e parandalimit dhe hulumtimit nga zjarri. Inspektorët kanë realizuar me sa vijon:

- janë kontrolluar 144 objekte private shoqërore,

- janë hartuar 129 proces verbale,
- janë dhënë 939 masa,
- janë hulumtuar 31 zjarre,
- janë lëshuar 40 vërtetime nga zjarri,
- janë dhënë 67 pëlqime për Elab. për MZ
- në Rregulloret e Mbrojtjes nga zjarri janë dhënë 10 pëlqime (konstatime)
- Raport me shkrim mbi zjarret 20 organeve komunale

Inspektorët për Mbrojtje dhe Shpëtim në kuadër të Sek.te EC në këtë periudhë i kanë realizuar objektivat e planifikuara dhe atë: janë vizituar dhe inspektua 40 shkolla fillore, 12 shkolla të mesme, 19 institucione parashkollore, janë inspektuar 15 raste emergjente në bazë të kërkesave të qytetarëve. Inspektorët për Mbrojtje dhe Shpëtim në bazë të proces verbaleve të hartuara kanë urdhëruar 62 subjekte që të hartojnë vlerësimet dhe planet për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë në afat kohor të paraparë me Ligj. Janë urdhëruar 168 masa të afatizuara për të gjitha subjektet e vizituara janë hartuar e dërguar 62 proces verbale. Brigada e zjarrfikësve gjatë këtij viti i ka realizuar detyrat dhe obligimet që janë paraqitur nga fatkeqësitë elementare apo zjarret në territorin e Komunës së Prishtinës, Fushe Kosovës dhe Obiliqit. Kjo Brigadë është e përgatitur dhe e specializuar mirë e aftësuar për fikjen e zjarrit, shpëtimin e njerëzve dhe të mirave materiale që janë të rrezikuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore.

Gjatë vitit janë realizuar të gjitha trajnimet e planifikuara profesionale siç janë : zjarrfikësit që e kanë kryer trajnimin për ndihmë të parë në Vushtrri, 6 zjarrfikës, trajnimin e avancuar dy mujor, 9 zjarrfikës, në verifikimin e testit psikik kanë qenë 11 zjarrfikës dhe Menaxhimin e vijës së parë me afat dy mujor e kanë kryer 2 zjarrfikës. Brigada gjatë vitit është pajisë me (4) katër automjete përkatëse dhe shkallë hidraulike, me 55 radiolidhje personale për zjarrfikës, me 130 bateri dore, 30 kërriga, me uniformë vere e dimri për të gjithë të punësuarit në Brigadën e Zjarrfikësve të Prishtinës.

Pasqyra 8: Intervenimet e Brigadës së Zjarrfikësve të Prishtinës gjatë 2009

Gjatë vitit 2009	Numri i Zjarreve	Intervenime Teknike	Numri i zjarrfikësve pjesëmarrës	Numri i automjeteve të përdorura	Orë pune në angazhim
Gjithsejtë	822	151	3739	1212	3713,01

f. Sektori i inspeksionit komunal

Gjatë vitit 2009, inspekcioni komunal ka kryer 31,269 kontrollime si dhe shumë aktivitete të tjera. Së bashku me inspektorët e tregut, inspekcioni komunal ka marrë pjesë në të gjitha aksionet për largimin e shitësve ambulant nga sipërfaqja publike dhe trotuare, më afërsi të tregut të gjelbër dhe në tregun të Ulpiana, në hyrje të QKU-së në rr. “Nënë Tereza” për largimin e shitësve të telefonave mobile, gjatë këtyre aksioneve sektori komunal ka bërë largimin nga sipërfaqja publike afër 10m³ goma të dala jashtë përdorimit të hedhura në sipërfaqen publike në rr “Lidhja e Lezhës”. Kemi konfiskuar afër 10m³ dru për djegieje të cilat i kemi dërguar në NKP-Hortikultura, kemi larguar tavolina të shitësve ambulant nga rr.”Ilaz Agushi” kemi bërë largimin e afër 15 m³ mbeturina të hedhura nga shitësit ambulant. Gjatë aksioneve me inspektorët e tregut kemi bërë konfiskime të mallit të shitësve ambulant ku këtë mall të konfiskuar e kemi dërguar në QRNF për kujdesin e fëmijëve dhe kemi

dërguar edhe në qendrën SOS-Kinderdorf. Në vijim është një tabelë përmbledhëse e aktiviteteve të inspektionit të komunal-komunikacionit.

Pasqyra 9: Aktivitetet e sektorit të inspektionit komunal-komunikacionit

Kontrollime	31,269
Procesverbale	4,697
Aktvendime	565
Fletëparaqitje	940
Kthim i lendes	8
Njoftime	824
Aksion me SHPK-	217
Kërkesa	756
Hapje te pusetave te kanalizimit te rrjetit te qytetit	117
Aksion për Largim –shtyllave metalike nga sip-publike-tezgave te shitësve ambulans-panove	1,340
Përcjellje e lendeve ne Drejtorin përkatëse	40
Aksion për largim te objekteve montuese –shtojcave te lokaleve-reklamave-platove	543
Aksion me PK-ne trafik	133
Aksion për largim te mbeturinave inerte	60
Aksion për largim te druve për djegieje	88
Aksion për largim te shitësve ambulans	175
Fletëthirrje për palën	291

8. DREJTORIA E ARSIMIT DHE KULTURËS

a. Të dhëna për arsimin në Komunën e Prishtinës

Drejtoria e Arsimit dhe e Kulturës gjatë vitit 2009 ka realizuar punët dhe detyrat sipas dinamikës së planifikuar. Në nivelin parauniversitar, në komunën e Prishtinës, edukimi dhe arsimimi i fëmijëve dhe nxënësve u zhvillua në 10 Institucione parashkollore (IP) publike, 5 IP private, 43 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta publike dhe 23 paralele të ndara fizike (PNF), 5 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta private, 17 shkolla të mesme të larta publike dhe 5 shkolla të mesme të larta private.

Në institucionet parashkollore publike, gjatë vitit 2009, kanë qenë të sistemuar 1936 fëmijë të të gjitha grupmoshave (prej të cilëve 231 serb), ndërsa në ato private rreth 570. Në nivelin e arsimit obligativ publik mësimin e kanë ndjekur 36,298 (prej tyre 1185 serb, 180 turq dhe 29 boshnjak), kurse në 40 paralelet parafilllore mësimin e ndoqën 1600 fëmijë. Në shkollat private mësimin e ndoqën 919 nxënës. Të gjithë këta nxënës dhe fëmijë ishin të sistemuar në 1315 paralele dhe 185 grupmosha. Nga këto të dhëna rezulton së mesatarja e nxënësve në paralele në këtë nivel ishte 27.6 sish. Po ashtu në shkollat e mesme të larta publike mësimin e ndoqën 14,153 nxënës (prej tyre 1275 serb, 111 turq dhe 23 boshnjak) të sistemuar në 364 paralele, ndërsa numri mesatar i nxënësve në paralele ishte 39. Në shkollat e mesme të larta private mësimin e ndoqën 943 nxënës.

Në të gjitha këto shkolla publike në të tri nivelet janë të punësuar 3320 mësimdhënës dhe shërbyes të tjerë për mësim në të gjitha gjuhët, kurse në shkollat private 132. Në krahasim me vitin paraprak, numri i fëmijëve në institucione parashkollore nuk ka ndryshuar sepse nuk janë rritur kapacitetet e objekteve, ndërsa në nivelet tjera numri i nxënësve është rritur

për 4% në përgjithësi, kurse në shkolla të mesme 6% për shkak të konkurrencës së madhe nga komunat tjera dhe ndikimit të disa faktorëve të tjerë.

Edhe në këtë vit shkollor institucionet publike të arsimit janë ballafaquar me mungesë të hapësirës së mjaftueshme shkollore, sidomos te ato të mesme të larta, sepse objektet të cilat i kemi filluar t'i ndërtojmë, ende nuk janë vu në funksion. Megjithatë, gjatë këtij viti janë inauguruar rreth 25,680 m² hapësirë shkollore, gjë që do të thotë se në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar gjendja është përmirësuar dukshëm në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta (pra nga 0.86 m² për kokë nxënësi të hapësirës mësimore sa ishte në vitin 2008, në vitin 2009 është rritur në 1.10 m² të hapësirës mësimore, gjë që nënkupton eliminimin e ndërrimit të tretë në 90% të shkollave).

b. Ngritja e infrastrukturës shkollore, kulturo-sportive dhe furnizimet

Gjatë vitit 2009 janë lëshuar në punë objektet shkollore të filluara viteve të mëparshme, ka filluar ndërtimi i shumë objekteve shkollore, objekteve të kulturës dhe sportit të cilat po ashtu janë inauguruar brenda këtij viti dhe ka filluar ndërtimi i disa objekteve të cilat nuk janë përfunduar, por vazhdojnë të ndërtohen gjatë vitit 2010.

Inaugurimi i objekteve të bartura nga viti 2008:

- Objekti i shkollës fillore dhe të mesme të ulët në lagjen Mati I 2500m²
- Objekti i shkollës fillore dhe të mesme të ulët në lagjen Vreshta 8200m²
- Objekti i PNF të shkollës fillore "Tefik Çanga" në Podaj-Koliç 400m²
- Qendra kulturore e fëmijëve në Gërmi-pjesa e parë 700m²
- Tereni sportive në shk.fill. "Zenel Hajdini"
- Tereni sportive në shk.fill "Emin Duraku"
- Tereni sportive në shk.fill. "Dardania"
- Objekti i Arkivit të Qytetit (Agjensioni Evropian) 1700 m²

Inaugurimi i objekteve të filluara gjatë vitit 2009:

- Objekti i shkollës fillore "Rilindja" në Keçekollë 1700 m²
- Objekti i shkollës fillore në Llukarë(MASHT) 2780 m²
- Objekti i shkollës fillore "Ganimete Tërbeshi" - PNF në Siçevë 400 m²
- Objekti i shkollës fillore "N.Mustafa" PNF në Rimanishtë 400 m²
- Objekti i shk.fill. "A.Rrustemi" - PNF në Suteskë 600 m²
- Aneksi i shkollës fillore "Nëna Tereze" në Vranidoll 600 m²
- Aneksi i shkollës fillore "Zenel Hajdini"(Komina-USAID) 800 m²
- Aneksi i shkollës fillore "Nazim Gafurri"(USAID-Komuna) 600 m²
- Aneksi i shkollës fillore "Iliria"(USAID-Komuna) 600 m²
- Aneksi i shkollës fillore "Ismail Qemali"(Komuna-USAID) 800 m²
- Restaurimi i Hamamit të Qytetit-pjesa e II-të
- Salla e ed.fizike në SHMM "Dr.Ali Sokoli". 600 m²

Projektet që ka filluar gjatë vitit 2009 dhe vazhdojnë ende:

- Objekti i shkollës së mesme afër shkollës bujqësore (MASHT) 6300 m²
- Objekti i shkollës së mesme në Çamër (MASHT) 6300 m²
- Objekti i shkollës fillore në Bardhosh (MASHT) 4400 m²
- Objekti i gjimnazit "Xh.Doda". 4200 m²

- Objekti i “Shkollës së Gjelbërt” - shkollë fillore (Komuna-USAID) në Çamëri 2000 m².
- Salla e ed.fizike në shk.fill. ”Xhemail Mustafa” 600 m²
- Salla e ed.fizike në shk.fill. ”Faik Konica”. 600 m²
- Salla e ed.fizike në shk.fill. ”Meto Bajraktari” 600 m²
- Salla e ed.fizike në shk.fill. ”Hilmi Rakovica”. 720 m²
- Salla e ed.fizike në shk.fill. ”Mitrush Kuteli” 600 m²
- Tereni sportive në Arbëri
- Tereni sportiv në Kodrën e Diellit
- Tereni sportiv në Hajvali
- Tereni sportiv oborin e shk.fill.në Keçekollë
- Tereni sportiv në shk.fill. ”Teuta” në Grashticë
- Tereni sportiv në shk.fill. ”Isa Boletini” në Busi

Projektet e tenderuara ndërtimi i të cilave do të fillojë në fillim të vitit 2010:

- Objekti i shkollës fillore “Në Themelim “në Arbëri
- Objekti i gjimnazit të përgjithshëm ”Në Themelim”në Kalabri (MASHT)
- Objekti i QKF në Gërmi-pjesa e II-të
- Objekti i bibliotekës së qytetit
- Salla e ed.fizike në SHMT ”28 Nëntori”.

Renovimet dhe gëlqerosjet dhe ndërtimi i dymve dhe dritareve:

- Janë gëlqerosur 15 objekte shkollore dhe institucioneve parashkollore
- Janë renovuar nyjet sanitare në 8 objekte shkollore dhe institucioneve parashkollore
- Janë ndërruar dritaret në shk.fill. ”Asim Vokshi” dhe në tri institucioneve parashkollore dhe pjesërisht në pesë objekte tjera shkollore
- Janë ndërruar kulmet në SHMT ”28 Nëntori” dhe në institucionin parashkollor ”Yllkat” dhe janë përmirësuar kulmet edhe në IP ”Dielli”, në objektin e bibliotekës “Hivzi Sylejmani”, në shk.fill. ”Shkëndia” dhe është rregulluar parketi në gjimnazin “Sami Frashëri
- Janë montuar sistemet e rezervuarëve të ujit në Shkollën e Mesme teknike ”28 Nëntori” dhe në gjimnazin “Sami Frashëri”.

Janë realizuar edhe projektet e furnizimit si: furnizimi me inventar shkollor, furnizimi me kompjuter dhe fotokopjues, furnizimi me material mësimor për institucione parashkollore, furnizimi me material didaktik për shk.fill.dhe të mesme, furnizimi me rekuizita dhe mjete mësimore sportive, furnizimi me material sanitar për të gjitha institucionet, furnizimi me lëndë djegëse, furnizimi i shkollave me gjeneratorë, transporti i nxënësve dhe i mësimeve, furnizimi me material riparues, elektrik dhe rekuizita didaktike, dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i të gjitha objekteve, trajnimet e punonjësve të arsimit, riparimet e nxemjeve dhe pajisjeve tjera, furnizimet me material administrativo-didaktik, furnizimi i nxënësve me tekste shkollore (mësimi obligativ) dhe furnizimi i bibliotekës së shk. Fill.”Meto Bajraktari” me 700 tituj librash.

c. Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor dhe aktivitetet tjera

Gjatë kësaj periudhe zyrtarët arsimorë kanë realizuar 103 vizita informative, 24 vizita të përgjithshme, 31 vizita të ngushta profesionale, 23 vizita speciale dhe 8 vizita kthyesë. Zyrtarët e arsimit, gjatë realizimit të vizitave nëpër shkolla, kanë kontrolluar dokumentacionin pedagogjik, plan-programet mësimore, kanë monitoruar punën e

mësimdhënësve në orët mësimore sipas planit- mbështetur në kapacitetet e drejtorisë, i kanë kontrolluar objektet dhe funksionalitetin e tyre, kanë përcjellë shkallën e vijueshmërisë së nxënësve, mësimdhënësve dhe të të punësuarve tjerë nëpër shkolla, kanë përcjellë shkallën e funksionimit të organeve profesionale dhe administrative të institucioneve shkollore, përkatësisht shkallën e bashkëpunimit me prindër, me institucione tjera dhe shoqërinë civile.

Ky shërbim ka analizuar vlerësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve nëpër shkolla sipas periodeve mësimore. Pas përfundimit të çdo vizite, zyrtarët e arsimit kanë shkruar raportet adekuate për gjendjet e konstatuara në shkolla. Janë bërë vlerësimet dhe janë dhënë propozim-masat për përmirësimin e gjendjes sipas nevojës. Sipas rezultateve të përpunuara, duke krahasuar rezultatet me vitin paraprak shkollor, shihet ngritje e shkallës së kalueshmërisë, ngritje e notës mesatare dhe ngritje e suksesit në pilot-testin e klasave të pesta, në provimin e semimaturës dhe maturës; shih pasqyrën krahasuese më poshtë.

Pasqyra 10: Ecuria e suksesit sipas viteve dhe niveleve të shkollimit

Niveli i shkollimit	Viti shkolror	Numri i nxënësve	Kalueshmëria	Nota mesatare	Arritshmëria në test
1-5	2007/08	18091	99.52%	4.18	41.40%
	2008/09	18398	99.70%	4.41	50.13%
6-9	2007/08	14093	99.10%	3.6	51.75%
	2008/09	15115	99.30%	3.89	58.28%
10-13	2007/08	11982	93.10%	3.41	53.50%
	2008/09	12878	94.30%	3.49	55.40%

Në këtë pasqyrë nuk janë përfshirë të dhënat e suksesit të mësimin në gjuhën serbe.

Aktivitetet tjera gjatë vitit 2009 kanë qenë:

- Garat e recitatorëve për të tri nivelet (janar-mars 2009)
- Garat e matematicientëve për nivelin e dytë dhe të tretë (prill-maj)
- Garat e diturisë për nivelin e parë dhe të dytë (mars-maj)
- Organizimi i shkollës së skijimit në Brezovicë (janar-mars)
- Organizimi i shkollës së notit në pishinën e Gërmisë (korrik-gusht)
- Përgatitjet teknike dhe bashkëpunimi në organizimin e pilot-testit vlerësues për nivelin e parë dhe organizimin e provimit të semimaturës dhe maturës
- Organizimi i 17 tipe trajnimesh (në bashkëpunim me MASHT-in, KEC-in dhe me organizata tjera trajnuese të jashtme ku janë përfshirë 554 mësimdhënës dhe të punësuar të tjerë.

d. Sektori i kulturës

Sipas prioriteteve, në sferën e kulturës janë realizuar të gjitha projektet e planifikuara nga fusha e promovimeve: 24 koncerte, 18 festivale brenda dhe jashtë vendit, përkrahje e 8 projekteve të shoqërisë civile, përkrahje e botimit të 27 veprave të ndryshme, 11 projekte nga veprimtaria filmiko-teatrore, 8 projekte të arteve pamore, 2 projekte nga trashëgimia kulturore, rritja e fondit të librit bibliotekar për 7500 ekzemplarë, punimi dhe përpunimi i lëndës arkivore në komunën e Prishtinës, integrimi i fëmijëve të moshave të ndryshme në rrjedhat socio-kulturore përmes Qendrës Kulturore të Fëmijëve, harmonizimi i qëndrimeve me institucione tjera përkatëse për rehabilitimin dhe konservimin e objekteve të ndryshme kulturore, kultivimi i vlerave të mirëfillta artistike përmes grupeve të ndryshme artistike si formë e punës me masa të gjera dhe hartimi i planit të veprimit për vitin 2010.

Janë mbuluar të gjitha ngjarjet e mëdha kulturore të rangut komunal dhe shtetërore në të cilat komuna ka shpenzuar 70,200 €

- Njëvjeteri i Pavarësisë së Kosovës..... 15.000€
- Dita e Evropës 7.000€
- Dita e Prishtinës 14.600€
- Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve..... 5.000€
- Dita e Shteteve të Bashkuara të Amerikës 4.600€
- Shpenzimet për derivate Teatri “Dodona”..... 2.000€
- Festivali Ndërkombëtar i fëmijëve “Ylberi i Prishtinës” 17.000€
- Festivali i fëmijëve në Osjek-Kroaci... 5.000€

Komuna ka mbështetur edhe krijimtarinë artistike me një shumë prej 120,700 €

- Ekspozita (arte pamore)..... 8.600€
- Veprimtaria botuese30.200€
- Veprimtaria teatrale dhe filmike39.500€
- Veprimtaria muzikore (promovimet).....25.500€
- Panelet dhe trajnimet 5.400€
- Shpenzime tjera..... 2.000€
- Datat historike dhe kulturore10.000€

Në total, ngjarjet kulturore në kryeqytet gjatë vitit 2009 janë përkrahur me 190,900 € Po ashtu, janë përkrahur edhe institucionet varëse të Komunës: Teatri “Dodona”, Qendra Kulturore e Fëmijëve, Biblioteka “Hivzi Sylejmani”, Arkivi i Qytetit dhe Instituti i Monumenteve, Teatri “Dodona”, Qendra Kulturore e Fëmijëve etj.

e. Sektori i sportit dhe rinisë

Sektori për Rini dhe Sport ka bashkëpunuar ngushtë me përfaqësues të sportit si dhe të OJQ-ve rinore. Jan realizuar aktivitete të ndryshme sportive dhe rinore duke shënuar data të rëndësishme historike, festat shtetërore dhe ndërkombëtare sportive-rinore si: Dita e Evropës 9 Maji, Dita e Prishtinës 11 Qershori, Liga Shkollore, Gjysmë Maratona ndërkombëtare “Prishtina 2009”, Muaji i Rinisë 2009, Turneu Memorial i Shahut “Hyzri Talla”, Shpallja e sportistëve 2009 etj.

Numri i klubeve sportive në regjistrin e klubeve sportive të Sektorit të Sportit në vitin 2009 është rritur nga 88 në 94. Gjithashtu janë organizuar takime të rëndësishme me përfaqësuesit e Agjencionit Evropian, GTZ, DIR dhe Departamentin e Sportit pranë MKRS dhe UNDP, pastaj me organizatën suedeze SISU “Sport for All” ku në bashkëpunim me këtë organizatë janë realizuar tri projekte të rëndësishme që kishin për qëllim bashkëpunimin e të rinjve dhe edukimin e tyre në krijimin e një ambienti sportivo- demokratik, takime me përfaqësues të klubeve sportive për të koordinuar zhvillimin e politikave sportive, si dhe pjesëmarrja në Kuvendin zgjedhor të Shoqatës së Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollor në nivel republikan e cila u mbajt në mars 2009, ku u bë përzgjedhja e strukturës organizative.

Sektori për Rini dhe Sport gjatë vitit 2009 ka përkrahur gjithsej 76 projekte te Klubeve sportive dhe OJQ-ve rinore: 56 klubeve sportive me një shumë prej 57,798 €dhe 20 OJQ-ve rinore me një shumë prej 25,180 € Nga subvencionet për rini dhe sport janë financuar edhe ngjarjet si Java e Evropës 4,000 € Dita e Prishtinës 7,500 € Muaji i Rinisë 9,500 € Shpallja e Sportistit te vitit 2009 dhe Turneu memorial i shahut “Hyzri Talla” 9,800 € Kështu në total, gjatë vitit 2009 komuna ka përkrahur aktivitetet rinore dhe sportive me një shumë prej 113,778 €

f. Shërbimi i administratës

Gjatë kësaj periudhe njëvjeçare kanë arritur 1176 lëndë prej të cilave janë miratuar 665, janë refuzuar 220,105 kanë qenë lëndë me karakter njoftimi, 161 përgjigje dhe 28 janë bartur në vitin 2010. Po ashtu në këtë shërbim janë proceduar rreth 13 konkurse të ndryshme për pranimin e kuadrit udhëheqës, mësimmhënësve dhe shërbimeve tjera në të gjitha nivelet. Janë kryer edhe punë tjera të natyrës administrativo-financiare, të pjesëmarrjes në komisionet vlerësuese në zyrën e prokurimit dhe shumë punë tjera organizative.

9. DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS LOKALE

Drejtoria për infrastrukturës lokale ka kryer këto aktivitete: hartimi i detyrave projektuese dhe identifikimi i nevojave, shqyrtimi i kërkesave të banorëve të bashkësive lokale dhe inkorporimi i tyre në planet e komunës, njoftimi me kohë i kompanive publike dhe subjekteve relevante me qëllim të koordinimit të punëve, incizimi i gjendjes ekzistuese të infrastrukturës në qytetin e Prishtinës, hartimi i paramasave dhe parallogarive si dhe kompletimi i dokumentacionit teknik për procedimin e tyre në organet kompetente, mbikëqyrja e realizimit të projekteve konform marrëveshjes etj.

a. Hartimi i detyrave projektuese dhe identifikimi i nevojave

Duke marrë për bazë ligjin mbi planifikimin hapësinorë, ligjin mbi ndërtimin e objekteve investive si dhe ligjin për projektim e në veçanti planet rregullative, janë hartuar detyrat projektuese për këto rrugë në zonat urbane:

- | | |
|----------------------------------|----------------------------|
| - Ibrahim Fehmiu | Rruga +kanalizimi+ndriçimi |
| - Hasan Remniku | Rruga +kanalizimi+ndriçimi |
| - Zgjerimi i rruges Bill Klinton | Rruga +kanalizimi+ndriçimi |
| - Hilmi Rakovica | Rruga +kanalizimi+ndriçimi |
| - Vlora | Rruga +kanalizimi |

Po ashtu janë kryer detyra projektuese edhe për këto rrugë rurale:

- | | |
|----------------------------------|--------------------|
| - Rr.Prugovcit | Asfaltim+kanalizim |
| - Siqevë-Sharban | Asfaltim |
| - Rimanisht -Siqevë | Asfaltim |
| - Vranidoll-Lagja e Serovcit | Asfaltim |
| - Koliq- Podaj | Asfaltim |
| - Stallovë-Crvadik-Zllash-Marevc | Asfaltim |
| - Slivovë(thanishtë)-Llajshevc | Asfaltim |
| - Bardhosh-Arbnesh | asfaltim |
| - Graqanicë-Sushicë | Kanalizim |
| - Graqanicë-Llapllasellë | Asfaltim |

Gjatë hartimit të projekteve nga kompanitë fituese të tenderit është kërkuar që këto kompani të kenë kontakte të vazhdueshme me drejtoratin komunal dhe kompanitë publike për përvetësimin e varianteve më të volitshme për projektimin e rrugëve dhe kanalizimeve.

b. Shqyrtimi i kërkesave

Gjatë vitit 2009 drejtorja ka proceduar 352 kërkesa të ndryshme të bashkësive lokale dhe banorëve: për ndërtimin e rrugëve, trotuareve dhe kanalizimeve, kërkesa për rregullimin e rrugëve dhe kanalizimeve me participim, kërkesa nga kompanitë publike-leje për gropim dhe intervenime për sanimin e defekteve të ndryshme, kërkesa të natyrave të ndryshme rreth çështjes së mirëmbajtjes së komplekseve banesore që nuk kanë qenë në kompetencë të drejtoratit, kërkesa nga kompanitë për formime të komisioneve për kontrollimin e punëve, kërkesa të natyrave të ndryshme rreth definimit të zgjidhjes në teren etj. Nga numri i përgjithshëm prej 352 kërkesave të pranuar, 349 janë zgjidhur sipas procedurës mbi L.P.A-s, ndërsa numri i pazgjidhur është në procedurë të zgjidhjes ku natyra e kërkesës kërkon një procedurë më të gjatë.

c. Projektet infrastrukturore

Në vitin 2009, Drejtorja e Infrastrukturës Lokale ka përfunduar 19 projekte të bartura nga vitit paraprak në vlerë të kontraktuar prej 2,757,046 € të cilat janë të paraqitura në vijim.

Pasqyra 11: Projektet infrastrukturore të vitit 2008 të përfunduara në vitin 2009

Nr	Emri i projektit	Vlera e punimeve	pagesat në vitin 2008	bartja e pagesave për vitin 2009
1	Rasim Kiqina	276,059.99	188,196.48	87,863.51
2	Sheshi i Arbërit	183,741.62	129,233.07	54,508.55
3	Ibrahim kelmendi	195,925.48	165,772.94	30,152.54
4	Asllan Pireva	463,334.28	262,887.05	200,447.23
5	Rruga Abdyl Rama-Naser Hajrizi	269,000.63	151,754.27	117,246.36
6	Ilir konushevc	483,146.67	426,323.84	56,822.83
7	Unaza e mbrendshme	1,289,434.60	626,251.33	663,183.27
8	rr.Fuat Dibra dhe Dem Ahmeti	263,456.43	175,637.62	87,818.81
9	Rr.Mbreti Piro	93,097.87	46,548.94	46,548.93
10	Lutfi Musiqi,Sylejman Jashari,Xhem Elezi,dhe pika tjera	80,000.00	69,448.63	10,551.37
11	Uliam Shekspir-Vlora -Sheh Muhedini	251,312.13	101,029.43	150,282.70
12	Rr.Hajvazi,Banesat e Bardha Ali Hadri,Nazim Gafurri,Muharrem Fejza	232,159.70	113,063.00	119,096.70
13	Zenel Bajraktari	142,374.22	71,187.11	71,187.11
14	Rrahman Murati	32,815.88	0.00	32,815.88
15	Slivovë-vitia e marevcit	799,464.90	260,892.98	538,571.92
16	Ndërtimi I rrugëve kat.IV	198,237.83	127,942.69	70,295.14
17	Rruget me beton	274,840.30	152,545.42	122,294.88
18	Sanim i rrafshit rrshqites në velani	238,445.57	0.00	238,445.57
19	Kanalizimi në Qagllavicë	66,937.30	8,022.00	58,915.30
	Gjithsej	5,833,785.40	3,076,736.80	2,757,048.60

Kontratat e reja të vitin 2009 në infrastrukturën rrugore janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Pasqyra 12: Projekte të kontraktuara për vitin 2009-Vëllimi fizik

Nr.	Emri i rrugëve	Kanalizim fekal	Kanalizim atmosferik	Gjatësia m	Sipërfaqe m ²
1.	Rrethrotullimi në lagjen Arbëri			210	
2.	Sanimi i gropave në qytet				6 500 asfalt
3.	Asfaltimi i rrugës "Vëllezrit Fazliu II"	2361	2361	2361.54	

4.	Anekskontrata Vllëzërit Fazliu	583			1163 asfalt
5.	Asfaltimi i rrugës në Prugovc			1250	
6.	Ndërtimi i stazave të këmbësorëve ne varreza				5200 kubza
7.	Asfaltimi i rrugës “Bardhosh-Bërnice e Ulët”			6500	
8.	Ndërtimi i rrugës “Ismet Krasniqi”			315	asfalt
9.	Ndërtimi i rrugës “Plava”			955	asfalt
10.	Rruga lidhëse me rrugën “Zenel Bajraktari”			60	kubza
11.	Ndërtimi i parkingjeve dhe platos te varrezat e qytetit				1435kubza
12.	Ndërtimi i rrugëve dhe platove në lagjen “Dardania”				18020 asfalt 5380 kubza 270 t asfalt
13.	Ndërtimi i rrugës “Vehbi Ibrahim”			170	
14.	Ndërtimi i rrugës”Demë Ahmeti”krahu i majtë			195	
15.	Ndërtimi i unazës Qendër pjesa e dytë	200	770	1563	6115pllaka
16.	Ndërtimi i kolektorit atmosferik dhe rruga mbi lumin Prishtina	1440	720	720	2540
17.	Asfaltimi i rrugëve,ndërtimi i stazave të këmbësorëve dhe platove në lagjen “Ulpiana”				13200kubza 8736asfalt
18.	Asfaltimi i rrugës “Rexhep Luci”			205	Asfalt
19.	Ndërtimi i rrugës “Hajdar Dushi”			365	Kubza
20.	Ndërtimi i rrugës “Verrat e Llukës”			325	kubza
21.	Ndërtimi i rrugës “Xhafer Deva”			320	
22.	Ndërtimi i kanalizimit në rrugën “Ali Ajeti”				
23.	Asfaltimi i platove,rrugëve te “Toskana”	300			8619asfalt
24.	Ndërtimi i rrethrotullimit te spitali				2410kubza 5930asfalt
25.	Ndërtimi i rrugës me zhavorr “Kolovicë-Butovc”			3350	zhavor
26.	Ndërtimi i rrugës me zhavorr në Ballaban			3000	
27.	Ndërtimi i rrugës në Janjevë			40	
28.	Rruget te bunari i Hajratit -Murat Gjaklaj -Esat Berisha -Xhelal Hajda - Nasiet Selimi - Jashar Erebara -Nesret Krasniqi	2279	1098	501 225 587 620 112 157	Asfalt Kubza , , , ,
29.	Asfaltimi i rruges Keqekoll-Ballaban			3000	Asfalt
30.	Asfaltimi i rruges Besi- Bllacaj Bardhosh-Milevc			2322 1568	Asfalt
31.	Ndërtimi i rrugëve ne lagjen Kalabria-Trotuaret ne kuvendin e Bujanit				

				1450	8880 pllaka
32.	Ndertimi i rrugeve lidhese me rrugen Vllezerit Fazliu	501		491	1635 pllaka
33.	Holgen Petersen-Sofali	1005	650	1005	Asfalt
34.	Rruga Nexhmedin Llumnica me rruget lidhese	530		1651	Asfalt Kubza(krihet)
35.	Rruget Xheladin Deda Petro Marko Ramiz Vlasi Kanalizim fekal			675 300	
36.	Ndërtimi i rrugës Xhevat Begolli,Mihajl Gramen dhe kanalizimi në Lugmir	1187		500	1520pllaka
37.	Ndërtimi i rrugës Haxhi Zeka faza e dytë			1980	asfalt
38.	Ndërtimi i shtigjeve të këmbësorëve në rrugën Nazim Gafurri				8955pllaka
39.	Ndërtimi i rrugës Ernest Zariqi			950	asfalt
40.	Ndërtimi i vend ndalimeve të autobusëve			250	asfalt
41.	Ndërtimi i urave në Mramuar dhe sanimi i rrugëve Vidimie-Lumi i Marevcit				
42.	Ndërtimi i rrugës Mehmet Beci	310		320	pllaka
43.	Ndërtimi i kanalizimit në lagjën Prugovc lagja II	1824			
44.	Ndërtimi i kanalizimit në lagjën Prugovc	3740			
45.	Ndërtimi i rrugëve dhe terenit sportiv në Bregun e Diellit				
46.	Lagja Janina , Aleksandër Gjovani	185		500	asfalt
47.	Ndërtimi i rrugëve Kolovic, Sofali	590		1130	
48.	Ndërtimi i shtigjeve të këmbësorëve në lagjet e qytetit				5500 pllaka
49.	Ndërtimi i rrugëve Burim Grajqevci ,Adem Keqekolla Mustafa Kruja	698			3283 pllaka

Si përmbledhje nga tabelat e mësipërme, rrugët e ndërtuara me asfalt dhe pllaka janë në gjatësi prej 41,988 metra, sipërfaqe të asfaltuara janë 49,238 m², sipërfaqe të ndërtuara me pllaka 54,658 m², kanalizime fekale në gjatësi prej 18,033 metra, kanalizime atmosferike 5,399 metra. Në total, është realizuar programit fizik dhe financiar për vitin 2009 në masën prej 90%.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur vëllimi financiar i projekteve të vitit 2009 (disa prej tyre për shkak të natyrës së punës vazhdojnë edhe në vitin 2010).

Pasqyra 13: Vlera financiare e projekteve të realizuara

Nr	Emëri i projektit	Vlera e punimeve	pagesat në vitin 2009	bartja e pagesave për vitin 2010	Mbetja nga projekti
1	Rreth rrotullimi ne lagjen Arberia	1,030,096.20	1,030,096.20	0.00	0.00

2	Hajdar Dushi Verat e Llukës Rexhep Luci	156,397.07	151,877.07	0.00	4,520.00
3	Sanimi I gropave ne qytet	154,402.36	154,402.36	0.00	0.00
4	Asfaltimi I rrugës „ Vëllëzërit Fazliu II"	2,284,103.90	2,284,103.90	0.00	0.00
5	Aneks Kontrata, „Vllezerit Fazliu"	137,606.84	49,368.51	0.00	88,238.33
6	Asfaltimi I rrugës në Prugovc	79,170.50	79,170.50	0.00	0.00
7	Ndërtimi I stazave të këmbësorëve në Vorreza"	87,570.40	82,870.40	0.00	4,700.00
8	Asfaltimi I rrugës „ Bardhosh - Bërnice e Ulët"	283,994.20	283,994.20	0.00	0.00
9	Ndërtimi I rrugës Ismet Krasniqi Plava Zenel Bajraktari Platot te Vorrezat e Qytetit	278,664.62	271,856.22	0.00	6,808.40
10	Ndërtimi I rrugëve dhe platove në lagjën Dardania Vehbi Ibrahim Dem Ahmeti	281,626.92	187,751.32	93,875.60	0.00
11	Ndërtimi I unazës Qendër pjesa e dytë	1,290,641.40	1,091,734.54	198,906.86	0.00
12	Ndërtimi I kolektorit atmosferik dhe rruga mbi lumin Prishtina	1,589,402.34	1,429,362.34	160,040.00	0.00
13	Asfaltimi I rrugëve , ndërtimi I stazave të këmbësorëve dhe platove në lagjën Ulpiana	330,815.00	264,399.24	0.00	66,415.76
14	Ndërtimi I rrugëve „ Xhafer Deva", ndërtimi I kanalizimit në rrugën „ Ali Ajeti", asfaltimi I platove , rrugëve te Toskana	235,893.19	204,776.12	0.00	31,117.07
15	Ndërtimi I rreth rrotullimit te Spitali	189,470.59	189,470.58	0.00	0.00
16	Ndërtimi I rrugës me zhavor „ Kolovic-Butovc Ballaban Janjev	86,533.67	85,613.67	0.00	920.00

17	Rrugët te Bunari I Hjaratit Murat Xhaklaj Esat Berisha Xhelal Hajda Nasjet Selimi Jashar Erebara Nasret Krasniqi	563,745.02	497,728.58	66,016.44	0.00
18	Asfaltimi I rrugës Keqekoll- Ballaban	576,301.72	570,151.72	0.00	6,150.00
19	Asfaltimi I rrugës Besi- Bllacaj" Bardhosh - Milevc	348,026.22	348,026.22	0.00	0.00
20	Ndërtimi I rrugëve në lagjën Kalabria Trotuaret në Kuvendin e Bujanit	169,434.76	122,678.60	46,756.16	0.00
21	Ndërtimi I rrugëve lidhëse në rrugën „ Vllëzërit Fazliu"	80,482.35	71,742.35	8,740.00	0.00
22	Hollgen Petersen Sofali	190,179.17	161,667.97	28,511.20	0.00
23	Rruga Nexhmedin Llumnica me rrugët lidhëse	201,361.78	168,838.05	32,523.73	0.00
24	Rrugët Xheladin Deda Petro Marko Ramë Vllasi Kanalizimi fekal	87,942.71	76,602.60	11,340.11	0.00
25	Ndërtimi I rrugës „ Xhevat Begolli" Mihajl Gramen dhe kanalizimi fekal në Lugmir	161,743.29	161,743.29	0.00	0.00
26	Ndërtimi I rrugës Haxhi Zeka Faza e dytë	155,398.40	153,912.00	0.00	1,486.40
27	Ndërtimi I shtigjeve të këmbësorëve në rrugën Nazim Gafurri	117,113.40	94,911.30	0.00	22,202.10
28	Ndërtimi I rrugës„ Ernest Zariqi"	83,758.48	64,824.86	18,933.62	0.00
29	Ndërtimi I vend ndalimeve të autobusëve	74,777.97	74,777.98	0.00	0.00
30	Ndërtimi I urave në Mramuer dhe sanimi I rrugëve Vidime- Lumi i Marevcit	29,138.00	29,138.00	0.00	0.00
31	Ndërtimi I rrugës Mehmet Beci	58,772.84	49,725.00	0.00	9,047.84
32	Ndërtimi I kanalizimit në lagjën Prugovc lagja II	76,653.30	0.00	76,653.30	0.00
33	Ndërtimi I kanalizimit në lagjën Prugovc	74,695.74	32,240.85	42,454.89	0.00

34	Furnizimi me armatur për rrugën Keqekoll-Ballaban	16,927.05	16,927.05	0.00	0.00
35	Ndërtimi I rrugëve dhe terenit sportiv në Bregun e Diellit	322,501.74	197,850.39	124,651.35	0.00
36	Lgja Janina ,Aleksander Gjuvani	115,484.88	38,600.44	76,884.44	0.00
37	Ndërtimi i rrugëve Burim Grqjgevc i Adem Keqekolla , Kruja	139,724.69	136,567.71		3156.98
38	Ndërtimi I Rrugëve Kolovicë,Sofali, Ali Ajeti dhe Mat-L e Krasniqeve	158,466.66	131,390.04	27,076.62	0.00
	Gjithsej	12,299,019.37	11,040,892.17	1,013,364.32	244,762.88

Si përmbledhje, në vitin 2009 vlera kontraktuese e punimeve ka qenë 12,299,019 € Shuma e mjeteve të realizuara është 11,040,892 € ndërsa shuma e mjeteve të bartura për vitin 2010 është 1,013.364 € Mbetjet e mbetura nga projektet e përfunduara janë në vlerë prej 244,762 €

d. Rrugët e përcjella në vitin 2010 për shkak të pengesave të ndryshme

Gjatë realizimit të projekteve në vitin 2009 kemi pasur edhe disa pengesa si në lagjen “Arbëria” ku ka mbetur pa u realizuar kanalizimi fekal për shkak të problemeve. Në disa raste të kontestet pronësore, procedurat e eksproprijimit edhe pse janë zgjedhur kanë marrë kohë deri sa janë zgjedhur. Në disa raste procedura e Prokurimit është dashur që të përsëritet dy herë e më tepër për shkak të kompanive të pamjaftueshme që kanë marrë pjesë në tender. Drejtorati i Infrastrukturës Lokale po ballafaqohet edhe me staf të pamjaftueshëm (nevojiten edhe 6 inxhinierë) për atë mbikëqyrja kanë qenë të ngarkuar me katër e më tepër objekte.

e. Hartimi i projekteve dhe përgatitja e dokumentacionit teknik

Duke u bazuar në kërkesat e shumta të qytetarëve për rregullimin urgjent të infrastrukturës rrugore në lagjet e tyre dhe domosdoshmëria e intervenimit, ekipi teknik hartoi këto projekte:

- Hajdar Dushi, Verat e Llukës, Rexhep Luci Rruga+kanalizimi
- Sanimi i Gropave në Qytet riparime
- Ndërtimi i stazave të kembësorëve vorreza trotuare
- Asfaltimi i rrugës Bardhish –B.ulet Rruga
- Ndërtimi i rrugës Ismet Krasniqi, Plava, Zenel Bajraktari dhe Platot të vorrezat e qytetit Asfaltim+kanalizim+trotuare
- Ndërtimi i rrugëve dhe platove në lagjen Dardania, Vehbi I brahimi dhe Demë Ahmeti Rruga +kanalizime
- Asfaltimi i rrugëve ,Ndërtimi i stazave të kembësorëve dhe platove në lagjen Ulpiana Asfaltim+trotuare
- Ndërtimi i rrugëve Xhafer Deva, Ali Ajeti, Asfaltimi i Platove dhe rrugëve të toskana Rruga+kanalizim+trotuare
- Ndërtimi i rreth rrotullimit të QKUK-ja Asfaltim+trotuare
- Ndërtimi i rrugëve me zhavor Kolovicë-Butovc, Ballaban, Janjevë Rruga
- Ndërtimi i rrugëve në Lagjen Kalabria dhe trotuaret në K. Bujanit Rrugë+Trotuare
- Ndërtimi i rrugëve Lidhese me rrugën Vllezerit Fazliu Rruga+kanalizimi
- Ndërtimi i rrugës Holgen Petersen dhe Sofali Asfaltim+Kanalizim

14. Rruga Nexhmedin Llumnica Me rruget Lidhese	Rruga+kanal.
15. Rruga Xheladin Deda,Petro Marko,Ramë Vllasi	Rruga+kanalizim
16. Asfaltimi i rruges Haxhi Zeka faza e II	rruga
17. Trotuaret ne Rr.Nazim Gafurri	trotuaret
18. Ndertimi i rruges Ernest Zariqi	Asfaltim
19. Ndertimi i vend ndalimeve te autobusve	Asfaltim
20. Ndertimi i urave ne Mramor	-
21. Ndertimi i rruges Mehmet Beci	Rruga+kanalizimi
22. Ndertimi i rrugeve dhe tereneve sportive ne Bregun e Diellit	Asfaltim
23. Lagja Janina-Aleksander Xhuvani	Asfaltim +Kanalizim
24. Ndertimi i rrugëve në Kolovic, Sofali, Ali Ajeti dhe në Mat –Lagja e Krasniqëve	Asfaltim +Kanalizim

10. DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DSHMS) veprimtarinë e vet gjatë vitit 2009 e ka zhvilluar përmes sektorit të shëndetësisë, sektorit të mirëqenies sociale dhe sektorit të inspektionit sanitar. Gjithsejtë në DSHMS janë të punësuar 10 nëpunës civil të cilët kryejnë të gjitha punët e përditshme të nevojshme që dalin nga obligimet e DSHMS dhe 5 inspektorë që kryejnë obligimet e tyre në kuadër të sektorit të Inspektionit Sanitar. Janë gjithsej 861 punëtorë të punësuar në kujdesin parësor shëndetësor dhe 49 punëtorë të punësuar pranë Qendrave për Punë Sociale.

Në vitin 2009 janë implementuar këto projekte:

- Ka vazhduar ndërtimi i QMF në: Lagja Vreshtat, Lagja Velania, Lagja Arbëria, Ajvali dhe ka filluar ndërtimi i QMF në Lagjen e spitalit dhe të ambulancës në fshatin Sharban.
- Renovimet në QMF 6 dhe QMF 5,
- Renovimet në ambulancat mjekësore në Barilevë, Koliq dhe Keqekollë,
- Deratizimi vjeshtorë i rrjetit të kanalizimit të Prishtinës,
- Deratizimi vjeshtorë i podrumëve dhe garazhave publike të Prishtinës,
- Dezinfektimi hapësinor i qytetit të Prishtinës për vitin 2009,
- Furnizimi me 2 auto ambulanca për nevojat e QMF dhe ENSH,
- Renovimi i kulmeve të QMF 2 dhe QMF në lagjen e Kalabrisë,
- Ndërtimi i ambulancës shëndetësore në fshatin Sharban (punët janë në vazhdim e sipër),
- Pajisjet mjekësore për nevojat e QMF
- Inventari i nevojshëm

Gjatë vitit 2009 janë kryer gjithsej 1,443,755 shërbime shëndetësore. Në qendrat e mjekësisë familjare janë realizuar të hyra nga bashkëpagesat-participimi në vlerë prej 186,772 €, ndërsa totali i shpenzimeve për barnat esenciale nga korporata arrin vlerën në 216,835 €. Është zvogëluar ngarkesa e Institutit të Biokimisë dhe të punoj ekskluzivisht vetëm për nevojat e QKUK-së, derisa laboratorët e QKMF dhe QMF-ve janë funksionalizuar në tërësi dhe punojnë me kapacitete maksimale. Në Entin e ndihmës së shpejtë mjekësore gjatë vitit 2009 janë realizuar 34,208 shërbime të ndryshme shëndetësore për qytetarët e Komunës të Prishtinës. Ekipe të ENSHM me autoambulanca kanë organizuar bartjen e pacientëve jashtë vendit në 36 raste (Tiranë 11 raste dhe Shkup 25 raste). QMF-të së bashku me ENSH-të kanë punuar me orar të pandërprerë 24 orë për çdo ditë, duke ofruar shërbime shëndetësore të gjitha niveleve të QMF-ve. Gjatë vitit 2009 kanë arritur 1,197 kërkesa, prej të cilave 245 janë refuzuar, 858 janë miratuar, janë lëshuar 93 njoftime dhe është dhënë një përgjigje.

DSHMS ka përkrahë projektin e Asociacionit të mjekësisë familjare të Kosovës dhe ekipin e Entit të ndihmës së shpejtë mjekësore për qëllime të edukimit të vazhdueshëm profesional.

a. Sektori i Inspektionit sanitar

Sektori i Inspektionit sanitar me punën e vetë në teren ka ndikuar në ruajtjen e shëndetit publik të qytetarëve duke zbatuar vendimin e largimit të shitësve të produkteve ushqimore nga rruga, largimin e shitësve të shpezëve dhe ndalimin e prerjes së shpezëve dhe bagëtive në rrugë. Inspektioni sanitar gjatë vitit 2009 ka kryer 2,629 kontrollime. Kanë asgjësuar mall të skaduar me vlerë prej 931,069. Janë inspektuar kushtet higjienike-sanitare në të gjitha lokalet publike dhe private, po ashtu është bërë inspektimi higjienike-sanitare i të gjitha pishinave në territorin e Prishtinës.

b. Sektorit të mirëqenies sociale

Sektorit të mirëqenies sociale në vitin 2009 i janë bashkëngjitë edhe 3 Qendra për punë sociale me 49 punëtorë. Sektori i Mirëqenies Sociale ka përkrahë OJQ-are të personave me nevoja të veçanta dhe të sëmurët rëndë si raste sociale për mes sigurimit të medikamenteve, trajtim mjekësorë, ndihmë emergjente në ushqim në shumën prej 34.681 € Komisioni i formuar për ndarjen e kiosqeve për familjet me asistencë sociale ka punuar dhe përpiluar listat e përfituesve të 17 kiosqeve (34 familje). Është strehuar përkohësisht në kontonjer në „Fushë të Pajtimit” një familje.

11. DREJTORIA E PRONËS

Gjatë vitit 2009, Drejtoria e Pronës kryer detyrat e punës nga fushë veprimtaria e saj si: shqyrtimi dhe vendosja sipas kërkesave të personave fizik dhe juridik lidhur me rregullimin e marrëdhënieve pronësore-juridike lidhur me pronën komunale, zhvillimi i veprimtarive procedurale administrative sipas detyrës zyrtare për ruajtjen e pronës dhe interesit komunal. Janë përgatitur raporte javore të cilat i janë dërguar Drejtorisë së Administratës dhe Personelit. Janë pranuar gjithsej 463 kërkesa të ndryshme rreth problemeve pronësore, prej të cilave 181 janë kryer dhe 267 janë në procedurë.

Në kuadër të lëndëve janë kryesisht kërkesa të palëve për definimin e statusit pronësor sidomos në rastet kur komuna ka intervenuar në ndërtimin e rrugëve. Një pjesë e kërkesave ka qenë nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale, e cila gjatë realizimit të projekteve rrugore ka hasur në probleme në shtrirjen e trasesë së rrugëve. Kërkesa kanë ardhur edhe nga Drejtoria e Arsimit dhe nga ajo e Shëndetësisë për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e objekteve shkollore dhe atyre shëndetësore. Ka pasur kërkesa edhe nga institucionet qendrore si dhe ato ndërkombëtare për dhënjën në shfrytëzim të lokacioneve.

Një numër i kërkesave ka arritur edhe nga Gjykata Komunale, Hetuesia etj. Natyra e kërkesave të këtyre institucioneve kryesisht ka qenë njoftimi për zhvillimet e procedurave si dhe është kërkuar nga Drejtoria e Pronës për verifikimin e origjinalitetit të dokumenteve të ndryshme si dhe format e procedurave të zhvilluara në nxjerrjen e këtyre dokumenteve. Një numër i konsiderueshëm i kërkesave ka arritur edhe për kompensimin e palujtshmërive të pronarëve privat të cilat parcela sipas planeve urbanistike janë paraparë për hapësira publike si rrugë, hapësira gjelbëruese, sheshe etj. Pjesa e konsiderueshme e këtyre kërkesave kanë mbetur pa u realizuar për shkak se në buxhetin e vitit 2009 nuk është paraparë ndonjë shumë e caktuar për kompensimin e këtyre personave privat si dhe ka pasur mungesë të

patundshmërive Komunale që të bëhet kompensimi tokë për tokë apo objekt për objekt. Në disa pjesë të qytetit janë nxjerr vendimet e eksproprijimit dhe për disa raste është bërë edhe kompensimi pas arritjes së marrëveshjes me personat privat.

Ekzistojnë edhe kërkesa të papërfunduara ende, të cilat lidhen me deeksproprijim të parcelave të cilat kanë qenë të eksproprijuara në periudhat e paraluftës ku personat kërkojnë që tu kthehen këto toka. Po ashtu disa lëndë të pakryera. Lëndët të cilat janë në procedurë janë kryesisht kërkesa të palëve për kompensimin e palujtshmërisë së tyre të cilat paluejtshmëri janë paraparë për hapësira publik këto parcela kanë mbetur pa u kompensuar derisa Kuvendi Komunal të siguroi mjete dhe hapësira përkatëse për kompensim.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. Nr. 31-643, më 01.04.2010

KRYESUESI I KUVENDIT

Sami Hamiti ecc. i dip.

ANEKSE

Aneksi 1. Të dhënat për aktivitete e Kryetarit të Komunës gjatë vitit 2009

Përshkrimi i aktiviteteve të Kryetarit	Numri i përgjithshëm i aktiviteteve	Numri i përafërt palëve
I. Qeverisja komunale dhe bashkëpunimi ndërinstitucional		
Takime me zyrtarë komunalë	183	330
Vizita në terren për inspektimin e punimeve infrastrukturore	147	
Drejtimi i grupeve punuese, Këshillit të Drejtorëve, mbledhjeve të Komitetit për Politike dhe Financa, mbledhje të ndryshme	54	
Takime konsultative individuale me drejtorët	104	
Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucione publike dhe administratë publike, lokale rajonale dhe qendrore	83	293
Takime për menaxhimin e ndërmarrjeve publike dhe për rritjen e efikasitetit të shërbimeve publike	55	184
Takime dhe bashkëpunim me përfaqësues të partive politike	97	320
Takim me Institucionet qendrore (Presidenti, Kryeministri, ministra, përfaqësues të Universitetit publik)	125	
Pjesëmarrje në ceremoni zyrtare, festa dhe ditë përkujtimore	87	
II Transparenca, komunikimi dhe përfshirja e qytetarëve në qeverisje		
Konferenca dhe seminare	45	
Takime individuale me qytetarë	225	850
Takime, prezantime, debate publike	95	
Takime me medie dhe drejtues të tyre	55	370
Pjesëmarrja në aktivitete kulturore	66	
Shoqëria civile (përfaqësues të OJQ-ve)	73	2250
Takim me përfaqësues të Sindikatës	15	72
Komuniteti fetar	13	57
Takime me përfaqësues të komuniteteve pakicë	33	
III. Siguria Publike		
Takime me përfaqësues të pranisë ushtarake ndërkombëtare KFOR, FSK-së dhe PK-së	45	
IV. Zhvillimi ekonomik		
Takime me investitorët e jashtëm	74	274
Bashkëpunim me institucione financiare ndërkombëtare dhe banka që operojnë në tregun vendor	52	154
Aktivitete për themelimin e Agjencisë dhe promovimin e Zhvillimit Rajonal	47	
Takime me biznesin lokal	175	445
V. Bashkëpunimi ndërkombëtar		
Takime me përfaqësues të ambasadave	37	123
Udhëtime zyrtare jashtë vendit	10	
Takime me përfaqësues të EULEX-it, ICO-s, OSBE-së, BE-së, BB-së, FMN-së, CPI-së, Komisionit Evropian etj.	64	237
Vizita të komunave dhe të përfaqësuesve politika nga jashtë	44	
VI. Shqyrtim i kërkesave të qytetarëve		
Kërkesa të shtruara Zyrës së Kryetarit	978 të gjitha të orientuara në organet kompetente për procedim adekuat	